# STRATEGJIA E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

# 2024-2028



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**SHKOLLA E MAGJISTRATURËS**

# STRATEGJIA E SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS
# 2024-2028

Mars, 2024

## PËRMBAJTJA

**Lista e shkurtimeve**

1. Hyrje …………………………………………………………………………………….........4

2. Përmbledhje ekzekutive ……………………………………………………......................5

3. Metodologjia e hartimit të strategjisë ………………………………..................................7

4. Vizioni dhe misioni i shkollës së magjistraturës ……………………….................................8

5. Kuadri ligjor dhe nënligjor ……………………………………………….................….......9

5.1 Ndryshimet në legjislacion ……………………………………........…………......9

5.2 ndryshimet në rregulloren e shkollës së magjistraturës………………………..….......11

6. Përmbledhje e analizës SWOT ……………………………………..............……….......13

7. Politikat strategjike dhe objektivat specifike për arritjen e tyre ……………………………...14

7.1 Politika strategjike nr. 1- Garantimi i aksesit në profesionin e magjistratit dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë ……………………………..............……………....14

7.2 politika strategjike nr. 2 - Kontributi në cilësinë e drejtësisë në vend ….....................17

7.3 politika strategjike nr. 3 - Kërkimi shkencor dhe publikimet, inovacioni dhe BE......18

8. Monitorimi dhe raportimi i strategjisë …………………………........................…………...27

**Shtojca 1** - Plani i veprimit për zbatimin e strategjisë së Shkollës së Magjistraturës 2024-2028 ……………………………………….........................................................................................28

**Shtojca 2** - Indikatorët e performancës ……………………………......................................39

**LISTA E SHKURTIMEVE**

| | |
|---|---|
| Shkolla e Magjistraturës | SHM |
| Këshilli i Lartë Gjyqësor | KLGJ |
| Këshilli i Lartë i Prokurorisë | KLP |
| Inspektori i Lartë i Drejtësisë | ILD |
| Programi i Formimit Fillestar | PFF |
| Programi i Formimit Vazhdues | PFV |
| Sistemi i Menaxhimit të Veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës | SMVSHM |
| Pikat e forta (Strength), Pikat e dobëta (Weaknesses), Mundësitë (Opportunities), Rreziqet (Threats) | SWOT |
| Shkolla e Administratës Publike | ASPA |

## 1. HYRJE

Profesionalizmi dhe merita kanë qenë dy elementet kyçe që përcaktuan sjelljen e aktorëve të sistemit të drejtësisë në Shqipëri ndaj Shkollës së Magjistraturës, por edhe të ekzekutivit dhe ligjvënësit, në çdo vendimmarrje që kishte të bënte me Shkollën.

Të vetëdijshëm për këto dy pika të forta, Shkolla, përgjatë viteve të pasreformës, ka synuar t'i mbajë ato të paprekura, t'i shohë me një frymë idealiste, por nga ana tjetër ka synuar të hedhë më shumë dritë mbi to, duke i zbërthyer, në mënyrë praktike dhe të matshme, në elemente të rëndësishme të punës së saj të përditshme.

Kërkesa për profesionalizëm në "ofertën" e Shkollës përfshin, së pari, pavarësinë dhe paanësinë e organeve vendimmarrëse në përzgjedhjen e stafit pedagogjik, si në Programin e Formimit Fillestar, edhe në Programin e Formimit Vazhdues. Përfshin gjithashtu pavarësinë dhe paanësinë e organit vendimmarrës për publikimet në Shkollë, në përzgjedhjen që bëhet për botimin e artikujve apo teksteve shkencore. Për shkak se koncepti i pavarësisë dhe paanësisë lidhen me elementin subjektiv të personave të përfshirë në këto procese, ato nuk janë lënë të pambështetura me elemente të mekanizmit që i realizon në praktikë këto procese. Si rrjedhojë, Shkolla ka pranuar modelin e procedurave dhe proceseve me shumë hallka, të vendosura në rend kronologjik, logjik dhe hierarkik, me shumë kontrolle dhe filtra të përcaktuara paraprakisht, në ligj apo Rregullore, në funksion të trajtimit të barabartë të çdo "kërkuesi", por edhe në mundësinë e evidentimit të talentit apo veçantisë (ekspertizës) së gjithkujt.

Kërkesa për profesionalizëm ka ngritur lart parimin e meritokracisë, parim që jo vetëm i jep zgjidhje kësaj kërkese, por e lartëson figurën e një profesionisti të zotë, e bën tërheqëse Shkollën për këdo që ka ambicie të jetë ndër më të mirët e drejtësisë, e bën të besueshëm çdo proces përzgjedhës/kualifikues, nxit konkurrencën në profesion, por edhe prek shpresën dhe besimin e shqiptarëve në drejtësi.

Shkolla e Magjistraturës ka pasur synim të jetë kurdoherë bashkëkohore, standardvendosëse e mësimdhënies, por edhe përparimtare në disa procese të rëndësishme nëpër të cilat po kalon vendi ynë, siç është forcimi i pushtetit gjyqësor, lufta kundër korrupsionit, liria e medias, barazia dhe mosdiskriminimi, integrimi në BE, e të tjera aspekte me rëndësi madhore për paqen sociale dhe forcimin e besimit dhe llogaridhënien që buron nga kontrata individ-shtet.

Kjo strategji e re përkon me një moment thelbësor të drejtësisë në Shqipëri: kërkesën për rezultate të prekshme dhe të matshme të përformancës së drejtësisë. Shkolla e Magjistraturës e vlerëson thelbësor rolin e saj në krijimin e të gjitha premisave që drejtësia të jetë cilësore.

Për këto arsye, politikat strategjike të Shkollës për pesëvjeçarin 2024-2028 do të fokusohen në arritjen e tri rezultateve kryesore. *E para*, Shkolla do të garantojë që magjistratët e rinj që hyjnë në sistem të kenë aftësi profesionale dhe etike të larta; *e dyta*, Shkolla do të kontribuojë që drejtësia e dhënë të jetë cilësore; dhe *e treta*, Shkolla do të përdorë çdo mjet kërkimor dhe inovator për ta bërë drejtësinë të bashkëjetojë me magjistratin dhe studiuesin e së drejtës si pjesë e pandarë, jo vetëm e rrugëtimit të tij profesional, por edhe atij njerëzor.

## 2. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Strategjia e Shkollës së Magjistraturës 2024-2028 është dokumenti i dytë strategjik institucional i pasreformës së sistemit të drejtësisë së vitit 2016, që vijon politikat strategjike të vendosura në Strategjinë e Shkollës së Magjistraturës 2019-2023. Kjo strategji e re nuk i shkëput lidhjet me dokumentin e parë strategjik, por është vijimësi logjike dhe reflektim i ecurisë së Shkollës përgjatë strategjisë së parë, bashkë me dimensionin e ri që është parashikuar për t'u realizuar përgjatë strategjisë së dytë. Edhe pse, në thelbin e tyre, përgjegjësitë dhe misioni kryesor i Shkollës nuk ka ndryshuar, momenti i hartimit të kësaj strategjie kërkon një ridimensionim të nivelit të politikave strategjike për të kontribuar në forcimin e Shkollës së Magjistraturës si institucion dhe në rritjen e performancës së saj.

Dokumenti strategjik "Strategjia e Shkollës së Magjistraturës 2024-2028" parashikon tri Politika Strategjike udhëheqëse, për realizimin e të cilave parashikohet përmbushja e dhjetë objektivave specifike. Realizimi i objektivave specifike do të matet me anë të masave të parashikuara për çdo objektiv dhe indikatorëve ose treguesve të performancës. Masat e parashikuara janë pjesë e Planit të Veprimit të Strategjisë 2024-2028. Indikatorët e performancës janë pjesë e Shtojcës 2, pjesë integrale e Strategjisë së Shkollës.

Strategjia përbëhet nga pjesa hyrëse dhe një shpjegim i metodologjisë së përdorur për hartimin e saj. Më tej, Strategjia vendoset në kontekstin ligjor dhe institucional, duke bërë një përmbledhje sintetike të kuadrit ligjor dhe nënligjor që rregullon veprimtarinë e Shkollës së Magjistraturës dhe një përmbledhje të analizës SWOT (pikat e forta, pikat e dobëta, mundësitë dhe rreziqet).

Në pjesën kryesore të Strategjisë janë përshkruar politikat strategjike të Shkollës për pesëvjeçarin e funksionimit të saj dhe janë shpjeguar objektivat specifike që duhet të përmbushen në funksion të tyre. Për secilën nga objektivat janë parashikuar masat që do të marrë Shkolla përgjatë këtyre viteve dhe sektorët apo nëpunësit përgjegjës për zbatimin e tyre.

Në mënyrë grafike, politikat strategjike dhe objektivat specifike paraqiten si më poshtë:


Objektivi specifik 2
Analiza dhe rishikimi i formatit dhe përmbajtjes së provimit të pranimit në Shkollë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike është në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për kandidatët, në çdo moment të karrierës së tyre, për të pasur sukses në provimin hyrës.
Objektivi specifik 1
Shkolla është një mjedis ftues dhe lehtësues për gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i aktivitetit të saj
Objektivi specifik 3
Shkolla ka të gjithë mekanizmat nënligjorë dhe institucionalë për realizimin e një procesi konkurimi të pavarur, të paanshëm, transparent dhe bazuar në meritë.
Politika strategjike 1
GARANTIMI I AKSESIT NË PROFESIONIN E MAGJISTRATIT DHE NËPUNËSVE TË TJERË CIVILË GJYQËSORË


Objektivi specifik 2
Programi i Formimit Vazhdues mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës.
Objektivi specifik 3
Shkolla ka mekanizma transparentë dhe efikas për përthithjen e ekspertizës së lartë profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre.
Objektivi specifik 1
Shkolla është një mjedis ftues dhe Kurrikula e Programit të Formimit Fillestar mundëson aftësimin e kandidatëve për profesionin e magjistratit/nëpunësit civil gjyqësor dhe avokatëve të shtetit
Objektivi specifik 4
Mekanizmat e vlerësimit dhe llogaridhënies të performancës së Shkollës së Magjistraturës janë transparentë dhe garantues të pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e saj, njëherazi garantues të cilësisë së drejtësisë.
Politika strategjike 2
KONTRIBUTI NË CILËSINË E DREJTËSISË NË VEND


Objektivi specifik 2
Metodat teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndëishëm të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht.
Objektivi specifik 1
Shkolla është e angazhuar në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës dhe nxjerr produkte shkencore dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë.
Objektivi specifik 3
Shkolla është e orientuar drejt kërkesave të tashme dhe të ardhshme që lidhen me procesin e integrimit në BE.
Politika strategjike 3
KËRKIMI SHKENCOR DHE POUBLIKIMET, INOVACIONI DHE BE

Për vlerësimin e zbatimit të Strategjisë është ngritur mekanizmi i monitorimit dhe raportimit, pjesë integrale e kësaj Strategjie. Raportet e prodhuara nga ky proces do të jenë kurdoherë publike në funksion të transparencës dhe llogaridhënies.

Strategjia dhe Plani i saj i Veprimit shoqërohet nga një analizë financiare e ndarë në vite, e cila mbështet realizimin konkret të masave të parashikuara.

## 3. METODOLOGJIA E HARTIMIT TË STRATEGJISË

Strategjia e Shkollës së Magjistraturës për vitet 2024-2028 është hartuar bazuar në një proces më shumë se 1-vjeçar, mbështetur në metoda kërkimi, analize dhe krahasimi. Grupi i kontribuuesve në hartimin e dokumenteve strategjike ka qenë nga Shkolla e Magjistraturës, drejtuar nga Drejtori i Shkollës me mbështetjen e stafit akademik dhe administrativ. Organet kolegjiale të Shkollës, Këshilli Pedagogjik dhe Këshilli Drejtues kanë luajtur një rol të rëndësishëm në çështjet e vlerësimit dhe vendimmarrjes së politikave strategjike dhe objektivave specifike të parashikuara në Strategji.

Procesi i hartimit të Strategjisë ka kaluar në katër faza kryesore:

1. Vlerësimi i nevojave;
2. Hartimi i projekt dokumenteve strategjike dhe parashikimeve financiare;
3. Konsultimi i projekt dokumenteve strategjike;
4. Miratimi i dokumenteve strategjike dhe publikimi i tyre.

1\. *Vlerësimi i nevojave* për parashikimet në Strategjinë e re ka qenë një proces që ka kërkuar një metodologji të posaçme, duke nisur nga përcaktimi i fazave që do të ndiqeshin për të realizuar një proces kërkimor të plotë dhe të gjithanshëm dhe ka përfunduar në hartimin e dy dokumenteve që do të shërbenin si bazë për vlerësim: a) Dokumenti analitik "Disa gjetje dhe reflektime mbi ecurinë e Shkollës së Magjistraturës në vitet e pasreformës. Pyetje dhe pritshmëri për pesë vitet e ardhshme 2024-2028" dhe b) Dokumenti "Disa burime kërkimi për realizimin e analizës së nevojave për Strategjinë e re".

Në mënyrë të përmbledhur, në këtë fazë, grupi i punës për hartimin e Strategjisë ka vlerësuar pozicionin e Shkollës së Magjistraturës në raport me të gjitha strategjitë kombëtare ku ajo bën pjesë; në raport me strategjitë institucionale të organeve kryesore të sistemit të drejtësisë në Shqipëri; ka analizuar progres raportet për Shqipërinë për vitet 2020-2023; ka vlerësuar rekomandimet dhe pritshmëritë e partnerëve ndërkombëtarë më të rëndësishëm për Shkollën; ka hulumtuar mbi shkollat homologe dhe standardet e përbashkëta dhe ka analizuar lidhjen kronologjike dhe logjike që do të ketë kjo strategji me Strategjinë e Shkollës 2019-2023.

2\. *Hartimi i projekt dokumenteve strategjike* është paraprirë nga një proces konsultativ i brendshëm, si dhe nga tryeza dhe workshop-e të organizuara për këtë qëllim.

3\. *Konsultimi i projekt dokumenteve strategjike* është realizuar në mbledhjet e Këshillit Pedagogjik.

4. *Miratimi i dokumenteve strategjike* u realizua në mbledhjen e Këshillit Drejtues të Shkollës, në datë 25 mars 2024, pas prezantimit të tyre nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës.

Menjëherë pas miratimit të tyre, dokumentet strategjike janë bërë publike në faqen zyrtare të Shkollës së Magjistraturës www.magjistratura.edu.al

## 4. VIZIONI DHE MISIONI I SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

Shkolla e Magjistraturës ka *mision* formimin fillestar dhe vazhdues të magjistratëve (gjyqtarë dhe prokurorë), të avokatëve të shtetit, ndihmësve ligjorë dhe kancelarëve në gjykata dhe prokurori me kompetencat e duhura për ushtrimin e funksioneve kushtetuese dhe ligjore në sistemin e drejtësisë me paanshmëri, profesionalizëm dhe integritet. Në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë, Shkolla ka rol të rëndësishëm në formimin profesional të administratës gjyqësore. Shkolla, nëpërmjet misionit të saj, synon të ketë ndikim thelbësor dhe të përhershëm në drejtësinë shqiptare, në shërbim të interesit publik, dhe, njekohësisht, në përmirësimin e kulturës ligjore dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi.

Pozicionimi i Shkollës si organ i parashikuar nga Kushtetuta dhe si organ qeverisës i sistemit të drejtësisë, por njëkohësisht tradita dhe emri i mirë i Shkollës përgjatë gjithë viteve të aktivitetit të saj, kërkon një qasje dhe një proces sistematik e gjithëpërfshirës në mënyrë që të drejtojë institucionin drejt së ardhmes apo vizionit të tij të dëshiruar.

Planifikimi strategjik është një ndër metodat më të rëndësishme që Shkolla e Magjistraturës përdor për të përcaktuar rrjedhën e veprimeve për përmbushjen e këtij vizioni.

Për vitet e veprimit të kësaj strategjie, Shkolla ka në *vizionin* e saj ofrimin e standardit më të lartë në formimin e magjistratëve dhe subjekteve të tjera pjesë e veprimtarisë së saj; përdorimin me efikasitet të çdo metode inovatore në drejtim të performancës së saj; orientimin drejt BE-së përmes zhvillimit të çdo mundësie trajnimi, bashkëpunimi, shkëmbimi me këtë synim; dhe përmirësimin institucional përmes metodave të vlerësimit, llogaridhënies, trajnimit dhe transparencës.

Misioni i Shkollës dhe vizioni i saj për të ardhmen mbështeten në *vlera dhe parime* që i japin mundësi konkrete zhvillimit të tyre. Vlera të tilla, si: integriteti, profesionalizmi, aksesi i barabartë, dinjiteti njerëzor, bashkëpunimi, transparenca, vlerësimi dhe llogaridhënia, janë pjesë integrale e çdo procesi akademik dhe administrativ që realizohet në Shkollë.

## 5. KUADRI LIGJOR DHE NËNLIGJOR

### 5.1 Ndryshimet në legjislacion

Statusi dhe veprimtaria e Shkollës së Magjistraturës rregullohet nga Kushtetuta, ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 98/2016, "Për organizimin e

pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil"; ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë".

Ligjet e reformës[1] kanë pësuar ndryshime[2] në vitet 2019, 2020, 2021, ndryshime që kanë prekur edhe çështje të veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës.

Së pari, *janë ndryshuar dhe plotësuar çështje të aksesit në Shkollë*. Konkretisht, ligjvënësi korrigjoi një problematikë që lindte në rastin e regjistrimit për në provimin hyrës në Shkollë, në rastin e diplomave të marra jashtë Shqipërisë. Ndryshimi i dispozitës rriti numrin e diplomave të vlefshme për t'u regjistruar në provim duke njohur edhe ato të vendeve që nuk janë pjesë e BE-së, mjafton që diploma të jetë e barasvlershme me diplomën e nivelit të dytë, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj[3].

Me po të njëjtat ndryshime ligjore u vendosën detajime të tri kërkesave të tjera ligjore, përvoja në punë dhe dy ndalime për të marrë pjesë në konkurrim. Konkretisht:

- U përcaktua se llogaritja e tri viteve të përvojës profesionale do të bëhet pas përfundimit të ciklit të plotë të studimeve universitare (cikli i parë dhe i dytë);
- U plotësua shkronja "d" e nenit 28, e cila parashikonte moskandidim në rastet kur kërkuesi është dënuar me vendim penal të formës së prerë. Ndryshimi i dispozitës kërkon që vepra penale të lidhet me një vepër penale, që, për shkak të natyrës së veprës së kryer, diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarit ose prokurorit ose dëmton rëndë besimin e publikut në sistemin gjyqësor, pavarësisht nëse është rehabilituar sipas parashikimeve të Kodit Penal. Ky detajim, nga njëra anë zgjeron të drejtën për konkurrim, pasi kufizon veprat penale të cilat janë pengesë për kandidim, por nga ana tjetër nuk njeh, në mënyrë përfundimtare, kushtet e shuarjes së veprave penale sipas ligjit penal.

[1] Shënim: Me termin "ligjet e reformës" i referohemi paketës ligjore të vitit 2016, në rastin e veprimtarisë së Shkollës së Magjistraturës, konkretisht: ligji nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; ligji nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

[2] Ligji nr. 47/2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë"; ligji nr.48/2019, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 15/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 149/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 50/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 46/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë"; ligji nr. 42/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë".

[3] Ligji nr. 50/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 7: "Në nenin 28 bëhen shtesa dhe ndryshimet e mëposhtme: 1. Shkronja "c" ndryshohet si më poshtë: "c) ka përfunduar me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet e integruara në drejtësi ose në një program të ciklit të dytë të studimeve universitare në drejtësi, të barasvlershëm me to, ose ka kryer me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës studimet universitare në drejtësi jashtë Shqipërisë dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj."

- U detajua edhe ndalimi sipas shkronjës "dh", e cila parashikonte kushtin që konkurrenti nuk ishte larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe nuk kishte masë disiplinore në fuqi. Kjo dispozitë u plotësua edhe me rastet e personave që iu është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, pavarësisht nëse masa disiplinore konsiderohet e shuar.

Së dyti, janë prekur *çështje të eficencës në funksion të emërimeve*. Konkretisht, ligjvënësi ka shtuar një dispozitë që kërkon që Shkolla të dërgojë pranë Këshillave, jo më vonë se muaji janar i çdo viti, listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik[4]. Kjo në funksion të përfundimit sa më të shpejtë të procesit të verifikimit të pasurisë dhe figurës që bëjnë Këshillat përpara emërimit si magjistratë të kandidatëve.

Së treti, janë prekur *çështje që lidhen me subjektet përfituese të trajnimit në Shkollë*. Ndryshimet në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë" që vendosën figurën e ndihmësit ligjor edhe pranë gjykatave të shkallës së parë (ligji i mëparshëm e parashikonte ndihmësin ligjor në gjykatat e apelit) dhe ndryshim të kriterit për pranim në këto pozicione në tri vite eksperiencë pune (nga kriteri i mëparshëm për eksperiencë pune 8 vite)[5], kanë sjellë potencialisht një numër më të lartë subjektesh në pozicionin e ndihmësit ligjor që do të përfitojë nga programet e Shkollës.

Ndryshimet në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë" që shtuan figurën e "këshilltarit ligjor" në Njësinë e Shërbimit ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme, sollën rrjedhimisht edhe të drejtën e tyre për të qenë pjesë e formimit fillestar dhe vazhdues në Shkollë[6], pra zgjeruan rrethin e subjekteve përfituese nga programet e Shkollës.

---

[4] Ligji nr. 50/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", neni 9: "Në nenin 34 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme: 1. Titulli i nenit ndryshohet si më poshtë: "Verifikimi i pasurisë dhe figurës dhe renditja e kandidatëve magjistratë të diplomuar". 2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë: "1. Çdo vit, jo më vonë se në fund të muajit janar, Shkolla e Magjistraturës u dërgon Këshillave listën e kandidatëve që mund të diplomohen në përfundim të vitit akademik për verifikimin e pasurisë dhe figurës, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenin 32 të këtij ligji.".

[5] Ligji nr. 46/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 98/2016, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", neni 9: "Në nenin 42 bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme: 1. Titulli i nenit ndryshohet në "Ndihmësit ligjorë të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit". 2. Pika 1 ndryshohet si më poshtë: "1. Pranë gjykatave të shkallës së parë dhe gjykatave të apelit mund të funksionojë Njësia e Shërbimit Ligjor, e përbërë nga ndihmësit ligjorë, e krijuar me vendim të Këshillit të Lartë Gjyqësor."; neni 12: "Në nenin 56 bëhen ndryshimet e mëposhtme: 1. Në pikën 2 pas togfjalëshit "Për pozicionin e ndihmësit ligjor në..." shtohet togfjalëshi "gjykatat e shkallës së parë dhe...". 2. Në pikën 2, shkronja "b" ndryshohet si më poshtë: "b) të kenë përvojë profesionale jo më pak se tre vjet si nëpunës në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose në organizatat ndërkombëtare."

[6] Ligji nr. 42/2021, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë", neni 1: "Në nenin 2, pas shkronjës "d" shtohet shkronja "dh" me këtë përmbajtje: "dh) "Këshilltar ligjor" është këshilltari që ushtron funksionin e tij në Njësinë e Shërbimit Ligjor pranë Prokurorisë së Përgjithshme"; neni 7: "Në nenin 72 bëhen këto ndryshime: 1. Në pikën 2, pas togfjalëshit "kryen formimin fillestar dhe vazhdues të kancelarëve" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarëve ligjorë në Prokurorinë e Përgjithshme" dhe pas togfjalëshit "për një periudhë prej të paktën tre muajsh" shtohet togfjalëshi "dhe për këshilltarët

## 5.2 Ndryshimet në Rregulloren e Brendshme të Shkollës së Magjistraturës

Rregullorja e Brendshme e Shkollës së Magjistraturës është akt nënligjor që vendos rregullat normative për marrëdhëniet që krijohen midis subjekteve pjesëmarrëse në veprimtarinë e saj. Ajo miratohet nga Këshilli Drejtues i Shkollës dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Shkollës. Rregullorja ka pësuar ndryshime që nga koha e miratimit të saj[7], ku më thelbësoret janë ndryshimet lidhur me provimin hyrës, ndryshimet në programet e formimit dhe ndryshimet në çështje të stafit akademik. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ka qenë: a) përmirësimi i rregullave lidhur me aksesin në provimin e pranimit; b) përmirësimi i programeve të formimit fillestar dhe vazhdues; c) rritja e eficencës së Shkollës në drejtim të sigurimit të stafit akademik. Konkretisht:

a) *përmirësimi i rregullave lidhur me aksesin në provimin e pranimit*

Ndryshimet në Rregullore kanë synuar, nga njëra anë, të heqin dispozita që mund të përbënin pengesë për hyrjen në Shkollë (për shembull konkurrimi në SHM nga stafi i brendshëm i saj, si dhe familjarë apo persona të lidhur me ta ishte i ndaluar për një periudhë deri në një vit nga koha e ndërprerjes së marrëdhënies së punës së tyre me Shkollën, rregull i cili është pezulluar për shkak të zgjidhjes së ndryshme që Shkolla i bën konfliktit të mundshëm të interesit në këtë rast. Gjithashtu, ndryshimi i parashikimit lidhur me gjuhën e huaj. Rregullorja e mëparshme quante të vlefshme vetëm gjuhën angleze. Me ndryshimet që iu bënë ajo njeh pesë gjuhët zyrtare të BE-së si të vlefshme për të marrë pjesë në provimin e pranimit).

Nga ana tjetër, ndryshimet kanë synuar të saktësojnë çështje të përllogaritjes së përmbushjeve të kritereve për të hyrë në provim (për shembull, mënyra e llogaritjes së mesatares etj.) dhe çështje të menaxhimit të provimit të pranimit (Rregullorja u plotësua me rregulla të sakta lidhur me mënyrën e administrimit të provimit, rolin e administratorit të provimit të pranimit etj.).

b) *përmirësimi i Programit të Formimit Fillestar dhe atij Vazhdues*

Ndryshimet në Rregullore synuan: *së pari*, të rrisin korrektesën në realizimin e Programit të Formimit Fillestar (për shembull u parashikua se mospjesëmarrja në 10% të lëndës përbën shkelje disiplinore për kandidatin); *së dyti*, të rrisin efiçencën në komponentët e Programit të Formimit Fillestar (për shembull, u plotësuan rregullat për vlerësimin e vazhdueshëm gjatë vitit të parë; u ristrukturua si nga forma edhe nga përmbajtja praktika paraprofesionale; u ndryshuan vendet e stazhit paraprofesional; u hoq detyrimi për mbrojtjen e një teme me natyrë akademike në fund të vitit të dytë të PFF-së); *së treti*, të rrisin paanësinë dhe profesionalizmin në procesin e vlerësimit të kandidatëve (nëpërmjet parashikimeve të ndryshimeve të grupeve të vlerësuesve); *së katërti*, të përmirësojnë metodologjitë e analizës së nevojave dhe realizimit të PFF-së dhe PFV-së

---

ligjorë për një periudhë prej të paktën nëntë muajsh". 2. Në pikën 4, pas togfjalëshit "për kancelarët" shtohet togfjalëshi "dhe këshilltarët ligjorë".

[7] Miratuar me vendimin nr. 1, datë 31.1.2017 të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës; ndryshuar me vendimet e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës: nr. 23, datë 23.10.2017; nr. 27, datë 20.11.2017; nr. 5, datë 22.1.2018; nr. 7, datë 21.3.2018; nr. 23, datë 28.6.2018; nr. 25, datë 24.9.2018; nr. 2, datë 29.1.2019; nr.5, datë 29.1.2019; nr. 22, datë 3.10.2019; nr. 25, datë 28.7.2020; nr. 41, datë 22.9.2020; nr. 52, datë 28.12.2020; nr. 53, datë 28.12.2020; nr. 3, datë 17.2.2021; nr. 21, datë 15.7.2021; nr. 31, datë 23.9.2021; nr. 1, datë 27.1.2022; nr. 16, datë 2.6.2022; nr. 3, datë 26.1.2023.

(për shembull, u shtuan dispozita të reja për organizimin e Departamentit të Formimit Fillestar, Departamentit të Formimit Vazhdues dhe Departamentit të Kërkimit Shkencor dhe Botimeve).

c) *rritja e efiçencës në drejtim të stafit akademik*

Ndryshimet në Rregullore shtuan figurën e "asistent pedagogut" me qëllim aktivizimin e tij, probono, në cilësinë e lehtësuesve në Programin e Formimit Fillestar dhe vendosën figurën e "pedagogut titullar të lëndës" për shkak të nevojës së organizimit dhe ndarjes së punëve për zhvillimin e një lënde të caktuar. Gjithashtu, pësoi ndryshime dhe plotësime procedura e përzgjedhjes së pedagogëve, u shtuan detyrime për ekspertët në Programin e Formimit Vazhdues dhe u vendos detyrimi i Këshillit Drejtues për të realizuar një proces analize të stafit akademik të brendshëm, një herë në tre vjet, bazuar në opinionet që kanë dhënë kandidatët për magjistratë për cilësinë dhe paraqitjen e pedagogëve të brendshëm përgjatë këtyre viteve në procesin e mësimdhënies.

Rregullorja e Botimeve, si pjesë e Rregullores së Brendshme të Shkollës së Magjistraturës (Aneksi 15 i saj), e cila përmban rregullat lidhur me mënyrën e funksionimit të aktivitetit të botimeve në Shkollë, ka pësuar ndryshime gjithashtu. Ndryshimet në Rregullore kanë prekur çështje të botimeve me synim forcimin e kapaciteteve të Shkollës në këtë drejtim. Konkretisht, është vendosur detyrimi i pedagogëve të brendshëm për të botuar të paktën një herë në vit një artikull në revistën "Jeta juridike", janë rishikuar rregullat për miratimin e kërkesave për botim, qoftë të ardhura nga gjyqtarë/prokurorë/pedagogë e studiues shqiptarë të së drejtës, edhe kërkesat nga donatorët si rrjedhojë e projekteve të ndryshme duke synuar vendimmarrjen në bazë konkurrimi dhe kriteresh të qarta. Gjithashtu, në funksion të paanësisë dhe konkurrencës, u rishikuan edhe rregullat për blerjen e teksteve të ndryshme për rritjen e fondit të bibliotekës së Shkollës. Ndryshimi i fundit në Rregullore parashikon krijimin e një lidhje të ngushtë mes trajnimit vazhdues-botimeve-kandidatëve për magjistratë në funksion të botimit në mënyrë periodike, çdo 3 muaj, të përmbledhjeve të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në Programin e Formimit Vazhdues. Ky ndryshim jo vetëm që pasuron botimet e Shkollës, por krijon një hapësirë të re ndërveprimi dhe studimi për kandidatët për magjistratë që do t'i shërbejë një marrëdhënie të vazhdueshme dhe të qëndrueshme në kohë mes tyre dhe Shkollës.

## 6. PËRMBLEDHJE E ANALIZËS SWOT

| PIKAT E FORTA | PIKAT E DOBËTA |
|---|---|
| • Shkolla e Magjistraturës gëzon autonomi administrative, akademike dhe financiare për realizimin e qëllimeve dhe detyrave të saj;<br>• Përbërja e organeve drejtuese të Shkollës përfshin aktorët më të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend;<br>• Lidershipi i Shkollës, Drejtori, gëzon statusin e mbartësit kryesor të suksesit të saj, njëherazi përgjegjësisë, përballë organeve drejtuese të Shkollës;<br>• Qëndrueshmëria financiare e Shkollës është garantuese e realizimit të Politikave Strategjike të saj;<br>• Shkolla ka një traditë të jashtëzakonshme në ruajtjen e standardeve më të larta të paanësisë, pavarësisë, meritokracisë dhe profesionalizmit;<br>• Ligji dhe Rregullorja garantojnë një ekspertizë të admirueshme të stafit akademik të Shkollës;<br>• Shkolla ka një staf administrativ të përkushtuar, të motivuar dhe të trajnuar. | • Lidhja që ligji i bën veprimtarisë së Shkollës me organe të tjera të sistemit të Drejtësisë ka shkaktuar paqartësi dhe probleme në efiçencë.<br>• Përcaktimi i kuotave të pranimit nga Këshillat në një hapësirë kohore shumë të afërt me nisjen e procesit të provimit e më tej trajnimit, e vendos Shkollën në gjendje pasigurie. |
| **MUNDËSITË** | **RREZIQET** |
| • Rritja e konkurrencës mes konkurrentëve si rrjedhojë e rritjes së pjesëmarrjes në konkurrim;<br>• Forcimi i besimit të publikut te Shkolla e Magjistraturës;<br>• Procesi i integrimit në BE dhe roli i Shkollës;<br>• Mbështetja e partnerëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë. | • Ndryshimet ligjore që mund të sjellin ndryshime thelbësore në veprimtarinë e Shkollës;<br>• Cënimi i standardit të mentorimit dhe vlerësimit në vitin e tretë të PFF-së;<br>• Ngarkesa e madhe në sistemin e drejtësisë reflektohet në mungesa në burime njerëzore në rolin e stafit akademik dhe ekspertizës në Shkollë, por edhe në mungesa në pjesëmarrjen në trajnim. |

## 7. POLITIKAT STRATEGJIKE DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKE PËR ARRITJEN E TYRE

Politikat strategjike paraqesin drejtimet kryesore të investimit të Shkollës së Magjistraturës për vitet 2024-2028. Ato janë reflektim i përgjegjësive kryesore të institucionit, kushtetuese dhe ligjore, por njëkohësisht paraqesin një mënyrë prioritizimi të tyre kundrejt subjekteve, pjesë e Shkollës, por edhe publikut. Përgjegjësia në përcaktimin e politikave të duhura strategjike lidhet, së pari, me pozicionin e Shkollës si organ qeverisës i sistemit të drejtësisë dhe, së dyti, lidhet drejtpërdrejt me kontributin që Shkolla kërkon të japë për drejtësinë në vend.

Përcaktimi i politikave strategjike dhe konkretizimi i tyre nëpërmjet objektivave specifike dhe masave në funksion të tyre i shërben edhe transparencës dhe llogaridhënies, si mekanizmat finalë matës të performancës së çdo institucioni përballë publikut.

### 7.1 POLITIKA STRATEGJIKE NR. 1

**Garantimi i aksesit në profesionin e magjistratit dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë**

Kushtetuta parashikon që për të ushtruar profesionin e magjistratit, duhet të jesh fitues i testimit të organizuar nga SHM-ja dhe të kesh përfunduar me sukses programin e formimit të ofruar prej saj. Ligji parashikon këtë mënyrë hyrje në sistemin e drejtësisë edhe për këshilltarët, ndihmësit ligjorë dhe kancelarët në gjykata dhe prokurori.

Realizimi i së drejtës për të hyrë në sistem si një prej këtyre subjekteve është përgjegjësi direkte e Shkollës. Kjo përgjegjësi shihet në një dimension të gjerë nga Shkolla, e cila kërkon që të ofrojë maksimumin e garancive për realizimin objektiv të saj.

Konceptimi i aksesit në profesionin e magjistratit dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë si politikë e parë strategjike e Shkollës duhet parë si angazhim i lartë i Shkollës për të garantuar se kushdo person, që plotëson kushtet që kërkon ligji, do të gjejë çdo mundësi reale për të konkurruar, në kushte të barabarta, pavarësisht moshës, profesionit të mëparshëm, apo kushte të tjera që do të përbënin shkak për të mos i motivuar për të marrë pjesë në konkurrim. Gjithashtu, Shkolla garanton se procesi i konkurrimit do të jetë në çdo rast, për çdo kategori subjektesh, transparent, i administruar dhe vlerësuar në mënyrë të pavarur dhe i bazuar vetëm në meritë.

Në përmbushjen e kësaj politike, Shkolla ka përcaktuar se është e rëndësishme të përmbushen tre objektiva specifikë:

*Së pari,* Shkolla të jetë një mjedis ftues dhe lehtësues për gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i veprimtarisë së saj.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 6 (gjashtë) masa.

*Së dyti,* Shkolla të analizojë dhe rishikojë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike formatin dhe përmbajtjen e provimit të pranimit.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 4 (katër) masa.

*Së treti*, Shkolla të ketë të gjithë mekanizmat nënligjorë dhe institucionalë të nevojshëm për realizimin e një procesi konkurrimi të pavarur, të paanshëm, transparent dhe të bazuar në meritë.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 2 (dy) masa.

Rezultatet që kërkohen të arrihen me anë të këtyre objektivave janë:

*Rezultati i kërkuar 1:* Konkurrentët potencialë që dëshirojnë të marrin pjesë në provimin e pranimit të mund të marrin çdo informacion që u nevojitet për provimin e pranimit dhe të ndërveprojnë me Shkollën në kohë reale përmes mjeteve dhe metodave të komunikimit të ofruara prej saj.

*Rezultati i kërkuar 2*: Provimi i pranimit në Shkollë është i përshtatshëm për çdo person që kërkon të nisë karrierën në sistemin e drejtësisë si një prej subjekteve, pjesë e aktivitetit të SHM-së.

*Rezultati i kërkuar 3*: Procesi i konkurrimit ofron të gjitha garancitë për të qenë transparent, i pavarur, i bazuar në meritë dhe i ankimueshëm, sipas ligjit.

Strategjia ka bërë një lidhje integrale ndërmjet objektivave specifike, rezultateve të pritshme për çdo objektiv specifik dhe masave konkrete që Shkolla do të marrë në funksion të realizimit të tyre. Kjo ndërlidhje, së bashku me shtrirjen në kohë të realizimit të masave dhe koston financiare të tyre është pjesë e planit të veprimit të kësaj strategjie.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur Politika nr. 1:

Tabela nr. 1: Paraqitje e Politikës Strategjike nr. 1

| **POLITIKA STRATEGJIKE NR. 1**<br>**Garantimi i aksesit në profesionin e magjistratit dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë** | | |
|---|---|---|
| **OBJEKTIVAT SPECIFIKE** | **REZULTATET E KËRKUARA** | **MASAT** |
| **Objektivi specifik 1.1:**<br>Shkolla është një mjedis ftues dhe lehtësues për gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i aktivitetit të saj. | **Rezultati i kërkuar 1**:<br>Studentët e drejtësisë marrin çdo informacion që u nevojitet për provimin e pranimit dhe ndërveprojnë me Shkollën në kohë reale përmes mjeteve dhe metodave të komunikimit të ofruara prej saj. | **1.1.1** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një material shpjegues të procesit të provimit të pranimit;<br>**1.1.2** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një përmbledhje të detajuar të programit të provimit të pranimit të konkretizuar me shembuj dhe pyetje nga tezat e mëparshme;<br>**1.1.3** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një material shpjegues |

| | | |
|---|---|---|
| | | mbi metodologjinë e vlerësimit të provimit të pranimit;<br>**1.1.4** Shkolla bashkëpunon me Fakultetin e Drejtësisë së UT-së dhe të Universiteteve të tjera të paracaktuara, bazuar në numrin e studentëve të tyre, me qëllim përthithjen e studentëve më të mirë në profesionin e magjistratit;<br>**1.1.5** Shkolla organizon trajnime para hyrjes në provimin e pranimit;<br>**1.1.6** Shkolla organizon fushata ndërgjegjësimi për kandidatët potencialë dhe kujdeset që ato të jenë gjithëpërfshirëse dhe të nxisin pjesëmarrjen edhe të kandidatëve të shkolluar jashtë Shqipërisë. |
| **Objektivi specifik 1.2:**<br>Analiza dhe rishikimi i formatit dhe përmbajtjes së provimit të pranimit në Shkollë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike është në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për kandidatët, në çdo moment të karrierës së tyre, për të pasur sukses në provimin hyrës. | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Provimi i pranimit në Shkollë është i përshtatshëm për çdo person që kërkon të nisë karrierën në sistemin e drejtësisë si një prej subjekteve, pjesë e aktivitetit të SHM-së. | **1.2.1** Shkolla analizon (përpunon të dhënat dhe i vlerëson ato) rezultatet e procesit të konkurrimit vit pas viti dhe i bën të njohura ato për aktorë të tjerë kryesorë të sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP, PP, Fakultete të Drejtësisë);<br>**1.2.2** Shkolla rishikon formatin e provimit të pranimit me qëllim maksimizimin e përshtatshmërisë së tij për çdo praktikues/studiues të së drejtës;<br>**1.2.3** Shkolla rishikon përmbajtjen e provimit të pranimit vit pas viti për të reflektuar ndryshime që ka pësuar ligji/praktika;<br>**1.2.4** Shkolla ka një grup pune të përhershëm që vlerëson nevojën për ndryshime në procesin e rekrutimit. |
| **Objektivi specifik 1.3:** | **Rezultati i kërkuar 1:** | **1.3.1** Shkolla ka rishikuar Rregulloren e Brendshme dhe |

| | | |
|---|---|---|
| Shkolla ka të gjithë mekanizmat nënligjorë dhe institucionalë për realizimin e një procesi konkurrimi të pavarur, të paanshëm, transparent dhe të bazuar në meritë. | Procesi i konkurrimit ofron të gjitha garancitë për të qenë transparent, i pavarur, i bazuar në meritë dhe i ankimueshëm, sipas ligjit. | rregulla të tjera që lidhen me procesin e konkurrimit;<br>**1.3.2** Shkolla ka ngritur mekanizma vlerësues për ecurinë e procesit të provimit dhe reflekton rezultatet e tij. |

## 7.2 POLITIKA STRATEGJIKE NR. 2

### Kontributi në cilësinë e drejtësisë në vend

Trajnimi i magjistratëve është garancia në kohë e cilësisë së drejtësisë dhe e përparimit të saj. Shkolla në thelb këtë e realizon me anë të dy programeve: Programin e Formimit Fillestar dhe Programin e Formimit Vazhdues.

Të dyja këto programe janë përballur përgjatë viteve të pasreformës me sfida të vazhdueshme. Nga njëra anë numri në rritje i kandidatëve që u bënë pjesë e Shkollës dhe standardi i lartë i trajnimit që Shkolla duhet të ofronte për ta, dhe, nga ana tjetër burimet e kufizuara njerëzore dhe infrastrukturore, krijuan kushte të reja që kërkonin analizë dhe rishikim të përvitshëm të elementeve të programit trajnues në Shkollë. Programi i Formimit Fillestar dhe ai i Formimit Vazhdues shfrytëzuan çdo mundësi ligjore dhe çdo burim njerëzor dhe financiar për të qenë efiçent dhe për të pasur sukses.

Dinamikat në sistemin e drejtësisë në Shqipëri, edhe për pesë vitet e ardhshme, së bashku me kërkesat gjithnjë në rritje për cilësi dhe harmonizim me standardet e shkollave homologe dhe kërkesat e Bashkimit Europian, tregojnë nevojën për analizë dhe përmirësim të metodologjive të përdorura nga Shkolla dhe përmirësim përmbajtjesor të Programit të Formimit Fillestar në funksion të aftësimit të magjistratëve dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë apo kategorive të tjera subjekte të formimit fillestar në Shkollë, për profesionin që ata do të ushtrojnë menjëherë pasi të përfundojnë trajnimin në Shkollë. Shkolla ka prioritet integritetin e magjistratit, rolin që ai ka në përmbushjen e standardeve që kërkon shteti i së drejtës dhe rolin që ai do të marrë si magjistrat europian.

Programi i Formimit Vazhdues ka një kriter themelor për të plotësuar: ai duhet të jetë i përshtatshëm për magjistratin. Ky është standardi ndërkombëtar për trajnimin në detyrë. Përshtatshmëria nuk është një term abstrakt dhe mbetet në dorë të organit që e ofron trajnimin ta shtjellojë këtë kërkesë dhe t'i japë dimensionet që ai vlerëson në përputhje me kontekstin ligjor dhe shoqëror të një vendi.

Konteksti ligjor dhe shoqëror në Shqipërinë e pasreformës është shumë kërkues ndaj performancës së gjyqësorit. Gjyqësori duhet të jetë në gjendje të prodhojë drejtësi "më të mirë", kjo është pritshmëria publike.

Përballë kësaj pritshmërie rritet edhe roli i Shkollës së Magjistraturës në ndërmarrjen e atyre masave që do të ndihmonin drejtësinë të ishte më cilësore. Fakti që gjyqësori dhe prokuroria

po ripërtërihen me më shumë se gjysmën e tyre, në një kohë të shkurtër, bën që sistemi i drejtësisë të ketë një shumicë magjistratësh të rinj, të dalë pas reformës në drejtësi. Ky moment është i rëndësishëm dhe i volitshëm për Shkollën, për të orientuar përparësitë në procesin e trajnimit të magjistratëve.

Në përmbushjen e kësaj politike, Shkolla ka përcaktuar se është e rëndësishme të përmbushen katër objektiva specifikë:

*Së pari*, Shkolla ka përgjegjësinë të hartojë një kurikul të Programit të Formimit Fillestar që mundëson aftësimin e kandidatëve për profesionin e magjistratit/nëpunësit civil gjyqësor dhe avokatit të shtetit.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 3 (tri) masa.

*Së dyti*, Shkolla ka përgjegjësinë e hartimit të një Programi të Formimit Vazhdues që mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 12 (dymbëdhjetë) masa.

*Së treti*, Shkolla ka përgjegjësinë të përthithë ekspertizën më të lartë profesionale duke krijuar mekanizma transparentë dhe efikasë në funksion të konkurrimit dhe përthithjes së ekspertizës.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 6 (gjashtë) masa.

*Së katërti*, Shkolla do të përmirësojë mekanizmat e vlerësimit dhe llogaridhënies së performancës së saj, në mënyrë që ato të jenë transparente dhe garantuese të pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e saj.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 5 (pesë) masa.

Rezultatet që kërkohen të arrihen me anë të këtyre objektivave janë:

*Rezultati i kërkuar 1*: Programi i Formimit Fillestar për dy vitet e para të tij përmban të gjitha aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për interpretimin dhe zbatimin e së drejtës nga magjistratët pas emërimit.

*Rezultati i kërkuar 2*: Programi i Formimit Fillestar për këshilltarët/ndihmësit ligjorë ka përshtatshmërinë e nevojshme për ushtrim të detyrave funksionale me nisjen e detyrës.

*Rezultati i kërkuar 3*: Programi i Formimit Fillestar për kancelarët është hartuar dhe zbatohet në lidhje të ngushtë me detyrat funksionale të kancelarëve në gjykata dhe prokurori dhe sipas veçorive të pozicionit në gjithë sistemin e drejtësisë.

*Rezultati i kërkuar 4*: Shkolla ka mekanizmat e duhur për bashkëpunim në funksion të eficencës dhe cilësisë së praktikës paraprofesionale dhe profesionale të kandidatëve për magjistratë.

*Rezultati i kërkuar 5*: Analiza e nevojave për trajnim bazohet në karakteristikat e gjithë subjekteve që marrin pjesë në trajnim në Shkollë.

*Rezultati i kërkuar 6*: Realizimi i aktiviteteve trajnuese bazohet në një program dhe metodologji që ofron qasje praktike ndaj profesionit dhe i përshtatet nevojave për specializim të tij.

*Rezultati i kërkuar 7*: Shkolla bën pjesë të kurikulës së PFV-së tema me ndjeshmëri kombëtare/ndërkombëtare për zhvillimin e së drejtës, integritetin e magjistratit, etikën dhe shtetin e së drejtës.

*Rezultati i kërkuar 8*: Shkolla vlerëson ndikimin e trajnimeve në punën e magjistratëve.

*Rezultati i kërkuar 9*: Shkolla realizon një proces të gjerë, të paanshëm dhe transparent për rekrutimin e pedagogëve në PFF dhe ekspertëve/lehtësuesve/specialistëve në PFV.

*Rezultati i kërkuar 10*: Shkolla ka mjete dhe metoda trajnimi efikase dhe bashkëkohore për trajnimin e stafit akademik në çdo fazë të karrierës së tij.

*Rezultati i kërkuar 11*: Shkolla ka mekanizma të paanshëm, transparentë dhe efikas për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe stafit tjetër të saj të angazhuar në PFF dhe PFV.

*Rezultati i kërkuar 12*: Shkolla ka mekanizma të paanshëm, transparentë dhe efikas për vlerësimin e performancës institucionale.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur Politika nr. 2.

Tabela 2: Paraqitje e Politikës Strategjike nr. 2

| **POLITIKA STRATEGJIKE NR. 2**<br>**Kontributi në cilësinë e drejtësisë në vend** | | |
|---|---|---|
| **OBJEKTIVAT SPECIFIKE** | **REZULTATET E KËRKUARA** | **MASAT** |
| **Objektivi specifik 2.1:**<br>Kurikula e Programit të Formimit Fillestar mundëson aftësimin e kandidatëve për profesionin e magjistratit/nëpunësit civil gjyqësor dhe avokatëve të shtetit | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Programi i Formimit Fillestar për dy vitet e para të tij përmban të gjitha aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për interpretimin dhe zbatimin e së drejtës nga magjistratët pas emërimit.<br><br>**Rezultati i kërkuar 2:**<br>Programi i Formimit Fillestar për këshilltarët/ndihmësit ligjorë ka përshtatshmërinë e nevojshme për ushtrim të detyrave funksionale me nisjen e detyrës.<br><br>**Rezultati i kërkuar 3:**<br>Programi i Formimit fillestar për kancelarët është hartuar dhe zbatohet në lidhje të ngushtë me | **2.1.1** Shkolla ka një grup pune të përcaktuar që analizon nevojat për ndryshim/plotësim të planeve dhe programeve mësimore për t'i përshtatur me profesionin e magjistratit, nëpunësit civil gjyqësor, avokatit të shtetit dhe kancelarit;<br><br>**2.1.2** Shkolla përmirëson planet dhe programet mësimore të PFF-së bazuar në rezultatet e kësaj analize.<br><br>**2.1.3** Shkolla bashkëpunon me KLGJ/KLP/PP, këshillat e gjykatave dhe prokuroritë për vlerësimin e nevojave për trajnim, në baza periodike. |

| | | |
|---|---|---|
| | detyrat funksionale të kancelarëve në gjykata dhe prokurori dhe sipas veçorive të pozicionit në gjithë sistemin e drejtësisë.<br><br>**Rezultati i kërkuar 4:**<br>Shkolla ka mekanizmat e duhur për bashkëpunim në funksion të eficencës dhe cilësisë së praktikës paraprofesionale dhe profesionale të kandidatëve për magjistratë. | |
| **Objektivi specifik 2.2:**<br>Programi i Formimit Vazhdues mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës. | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Analiza e nevojave për trajnim bazohet në karakteristikat e gjithë subjekteve që marrin pjesë në formimin vazhdues në Shkollë.<br><br>**Rezultati i kërkuar 2:**<br>Realizimi i aktiviteteve trajnuese bazohet në një program dhe metodologji që ofron qasje praktike ndaj profesionit dhe i përshtatet nevojave për specializim të tij.<br><br>**Rezultati i kërkuar 3:**<br>Shkolla bën pjesë të kurikulës së PFV-së tema me ndjeshmëri kombëtare/ndërkombëtare për zhvillimin e së drejtës, integritetin e magjistratit, etikën dhe shtetin e së drejtës.<br><br>**Rezultati i kërkuar 4:**<br>Shkolla vlerëson ndikimin e trajnimeve në punën e magjistratëve. | **2.2.1** Shkolla rishikon metodologjinë e analizës së nevojave për trajnim bazuar në standardet ndërkombëtare duke reflektuar analizën e nevojave për trajnim të magjistratëve të rinj, nevojën për specializim të magjistratëve sipas fushave të caktuara dhe karrierës që kanë në gjyqësor apo prokurori dhe nevojën për trajnim të kategorive të tjera, si ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit, inspektorët e ILD-së, kancelarët e gjykatave/prokurorive, etj.;<br>**2.2.2** Shkolla bën vlerësim *ex-post* për ecurinë e cikleve të specializuara të trajnimeve me synim analizën e nevojës për vijimësinë e tyre;<br>**2.2.3** Shkolla bashkëpunon ngushtësisht dhe mbi baza periodike me KLGJ/KLP-në, këshillat e gjykatave, magjistratët në sistem, subjektet e tjera përfituese të trajnimit dhe organe të tjera të përfshira në procesin e analizës së nevojave për trajnim, bazuar në ligj, Rregullore dhe marrëveshje dypalëshe (nëse është rasti); |

| | | |
|---|---|---|
| | | **2.2.4** Programi i Formimit Vazhdues ofron cikle trajnimi për magjistratët e rinj në sistem.<br>**2.2.5** Programi i Formimit Vazhdues ofron cikle trajnimi disa ditore, të cilat synojnë trajtim ndërdisiplinor dhe/ose shterues të çështjeve të ndryshme të së drejtës.<br>**2.2.6** Programi i Formimit Vazhdues ofron aktivitete trajnuese me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare, përfshirë trajnime mbi ligjin e BE-së, integritetin e magjistratit, etikën, shtetin e së drejtës etj.;<br>**2.2.7** Programi i Formimit Vazhdues parashikon trajnime të veçanta, "tailor made", për magjistratët e të tri niveleve, për funksione të veçanta që ata mund të marrin, si drejtues, magjistratë shtypi, mentorë etj.<br>**2.2.8** Programi i Formimit Vazhdues parashikon trajnime të posaçme dhe/ose integron në aktivitete trajnuese këshilltarët/ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit, inspektorët e ILD-së, kancelarët e gjykatave/prokurorive dhe administratën gjyqësore (kur vlerësohet e përshtatshme).<br>**2.2.9** Shkolla organizon trajnime rajonale në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat/prokuroritë "pritëse".<br>**2.2.10** Shkolla ndjek një metodologji interaktive, bazuar në kompetencat dhe aftësitë e subjektit të trajnimit dhe të përputhur me standardet ndërkombëtare, në realizimin e aktiviteteve trajnuese. |

| | | |
|---|---|---|
| | | **2.2.11** Shkolla realizon vlerësim afatshkurtër dhe afatgjatë të ndikimit të trajnimit bazuar në një metodologji të standardizuar (standardet e EJTN-së) për procesin e vlerësimit të impaktit të trajnimit në punën e magjistratëve;<br>**2.2.12** Shkolla publikon raportet e hartuara në përfundim të këtij procesi. |
| **Objektivi specifik 2.3:**<br>Shkolla ka mekanizma transparentë dhe efikas për përthithjen e ekspertizës së lartë profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre. | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Shkolla realizon një proces të gjerë, të paanshëm dhe transparent për rekrutimin e pedagogëve në PFF dhe ekspertëve/lehtësuesve/specialistëve në PFV.<br><br>**Rezultati i kërkuar 2:**<br>Shkolla ka mjete dhe metoda trajnimi efikase dhe bashkëkohore për trajnimin e stafit akademik në çdo fazë të karrierës së tij. | **2.3.1** Shkolla ndërmerr, në mënyrë periodike, një proces promovues/informues të mundësive për angazhim në PFF dhe PFV;<br>**2.3.2** Shkolla rishikon rregullat për konkurrim në PFF dhe PFV;<br>**2.3.3** Shkolla realizon procesin e konkurrimit dhe bën publike vendimmarrjen e saj;<br>**2.3.4** Shkolla vlerëson nevojat për trajnim trajnerësh në mënyrë të përvitshme;<br>**2.3.5** Shkolla realizon aktivitete trajnimi për trajnerët dhe/ose bashkëpunon ngushtësisht me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në realizimin e tyre;<br>**2.3.6** Shkolla ndërmjetëson në ofrimin e mundësive për trajnim të trajnerëve të saj në shkollat homologe ose institucione ndërkombëtare të trajnimit. |
| **Objektivi specifik 2.4:**<br>Mekanizmat e vlerësimit dhe llogaridhënies të performancës së Shkollës së Magjistraturës janë transparentë dhe garantues të pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e saj, njëherazi | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Shkolla ka mekanizma të paanshëm, transparentë dhe efikas për vlerësimin e performancës së stafit akademik dhe stafit tjetër të saj të angazhuar në PFF dhe PFV. | **2.4.1** Shkolla ka rishikuar rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme lidhur me vlerësimin e performancës së stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe ekspertizë; |

| | | |
|---|---|---|
| garantues të cilësisë së drejtësisë. | **Rezultati i kërkuar 2:** Shkolla ka mekanizma të paanshëm, transparentë dhe efikas për vlerësimin e performancës institucionale. | **2.4.2** Shkolla harton raporte individuale periodike për stafin e angazhuar në mësimdhënie dhe ekspertizë dhe i njofton rezultatet e tij subjektit të vlerësimit.<br>**2.4.3** Shkolla ka hartuar një metodologji për mënyrën e vlerësimit të performancës së Departamenteve;<br>**2.4.4** Shkolla ka një staf administrativ të kualifikuar dhe të trajnuar për të realizuar procese kërkimi, përpunimi të dhënash, analize etj.;<br>**2.4.5** Shkolla publikon raportet e monitorimit të ecurisë së kësaj strategjie në mënyrë vjetore. |

## 7.3 POLITIKA STRATEGJIKE NR. 3

**Kërkimi shkencor dhe publikimet. Inovacioni dhe BE-ja**

Kërkesa që Shkolla të jetë një qendër që realizon kërkime, studime dhe publikime shkencore me qëllim dhënien e një kontributi ekselent në fushën e së drejtës e tejkalon kontributin e parë dhe thelbësor që Shkolla ka në formimin dhe trajnimin e magjistratëve. Ky "tejkalim" i përgjegjësisë kryesore të Shkollës është parë si një sfidë shumë e madhe, herë pas here është shoqëruar me dilema nëse do të mund të realizohej ndonjëherë, nëse ishte një aktivitet i përshtatshëm për Shkollën ose jo, e të tjera pyetje e vështirësi në të cilat është hasur ky aktivitet i Shkollës prej fillimit.

Përpara vlerësimit se vendi ka një nevojë, thuajse emergjente, për punime shkencore që ndikojnë në të drejtën, që e avancojnë atë dhe rrisin mundësitë për një drejtësi më cilësore, duket se çdo vështirësi në realizimin e saj ka më pak rëndësi.

Shkolla përgjatë kësaj strategjie do të bëjë çdo përpjekje, do të përdorë çdo mjet inovator dhe të efektshëm, në mënyrë që të rrisë numrin e magjistratëve dhe studiuesve të së drejtës që do të krijojnë në Shkollë grupet e kërkimit dhe studimit, që do të marrin pjesë aktivisht në diskutime mbi çështje të rëndësishme të së drejtës, që do t'i shërbejnë në mënyrë të drejtpërdrejtë sistemit të drejtësisë me anë të manualeve, përmbledhjeve, e publikimeve të ndryshme. Shkolla do të krijojë të gjitha hapësirat që diskutimet të nxiten, të pasojnë njëra-tjetrën dhe që këto diskutime të adresohen në struktura të tjera shtetërore, kur të vlerësohet e arsyeshme.

Në përmbushjen e kësaj politike, Shkolla ka përcaktuar se është e rëndësishme të realizohen tre objektiva specifikë:

*Së pari*, kërkohet që Shkolla të angazhohet në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës dhe të nxjerrë produkte shkencore dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 8 (tetë) masa.

*Së dyti*, kërkohet që Shkolla të lehtësojë dhe nxisë bashkëpunimin e magjistratëve dhe subjekteve të tjerë pjesë e veprimtarisë së saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht, me anë të metodave teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 9 (nëntë) masa.

*Së treti*, objektiv shumë i rëndësishëm i Shkollës është orientimi drejt kërkesave të tashme dhe të ardhshme që lidhen me procesin e integrimit në BE.

Për realizimin e këtij objektivi Shkolla ka parashikuar 4 (katër) masa.

Rezultatet që kërkohen të arrihen me anë të këtyre objektivave janë:

*Rezultati i kërkuar 1*: Shkolla ka grupe studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës.

*Rezultati i kërkuar 2*: Shkolla publikon revista shkencore dhe publikime të tjera sipas Rregullores *në mënyrë periodike.*

*Rezultati i kërkuar 3*: Shkolla ka mundësi ndërveprimi të gjerë dhe vizibilitet të lartë.

*Rezultati i kërkuar 4*: Shkolla ka eficencë të lartë në përpunimin e të dhënave dhe analizës për gjithë veprimtarinë e saj.

*Rezultati i kërkuar 5*: Shkolla është në gjendje të ndjekë dhe monitorojë ecurinë e të gjitha detyrimeve që i burojnë si rrjedhojë e procesit të integrimit në BE.

*Rezultati i kërkuar 6*: Ligji i BE-së është pjesë integrale e formimit të kandidatëve dhe trajnimit të magjistratëve.

Më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur Politika nr. 3.

Tabela 3: Paraqitje e Politikës Strategjike nr. 3

| **POLITIKA STRATEGJIKE NR. 3**<br>**Kërkimi shkencor dhe publikimet. Inovacioni dhe BE** | | |
|---|---|---|
| **OBJEKTIVAT SPECIFIKE** | **REZULTATET E KËRKUARA** | **MASAT** |
| **Objektivi specifik 3.1:**<br>Shkolla është e angazhuar në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës dhe nxjerr produkte shkencore | **Rezultati i kërkuar 1**:<br>Shkolla ka grupe studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës. | **3.1.1** Shkolla ka një mekanizëm dhe metodologji përzgjedhëse të personave që do të jenë pjesë e grupeve të kërkimit dhe studimit. |

| | | |
|---|---|---|
| dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë. | **Rezultati i kërkuar 2:** Shkolla publikon revista shkencore dhe publikime të tjera sipas Rregullores në mënyrë periodike. | **3.1.2** Shkolla trajnon kërkuesit e rinj që i bashkohen grupeve të studimit/kërkimit. **3.1.3** Shkolla realizon punë paraprake kërkimore dhe analizuese në funksion të studimit të grupeve të ngritura, vlerëson produktet e realizuara dhe vendos për mundësitë dhe mjetet për vizibilitetin e tyre. **3.1.4** Shkolla boton, në mënyrë periodike, përmbledhje të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në Programin e Formimit Vazhdues; **3.1.5** Shkolla boton revistën shkencore "Jeta Juridike" dhe "Magjistrati"; **3.1.6** Shkolla përgatit manuale, module/cikle leksionesh për lëndë apo tema që trajtohen në procesin e Formimit Fillestar të magjistratëve, nga grupe autorësh. **3.1.7** Shkolla boton tituj me praktikë gjyqësore (*Case study*) dhe publikime të tjera shkencore në funksion të studiuesve të së drejtës. **3.1.8** Shkolla organizon një konferencë shkencore në vit mbi zhvillime të rëndësishme të së drejtës. |
| **Objektivi specifik 3.2:** Metodat teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm | **Rezultati i kërkuar 1:** Shkolla ka mundësi ndërveprimi të gjerë dhe vizibilitet të lartë. **Rezultati i kërkuar 2:** Shkolla ka eficencë të lartë në përpunimin e të dhënave dhe | **3.2.1** Shkolla përdor module *e-learning* të prodhuara në Europë ose të krijuara në Shkollë; **3.2.2** Shkolla shkëmben burime (dokumente, botime shkencore, kurikula trajnimi dhe çdo "mjet trajnimi" tjetër, i cili do të mund të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe dijeve të sistemeve |

| | | |
|---|---|---|
| të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht. | analizës për gjithë veprimtarinë e saj. | gjyqësore dhe juridike përkatëse) me shkollat homologe dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë;<br>**3.2.3** Shkolla ka kapacitete për të zhvilluar, dorëzuar dhe menaxhuar projekte që lidhen me trajnimin gjyqësor, veçanërisht në kuadër të Programit të BE-së për Drejtësi dhe në partneritet me EJTN dhe anëtarët e saj;<br>**3.2.4** Shkolla ka bibliotekë digjitale të pasuruar në mënyrë të vazhdueshme dhe abonime në biblioteka prestigjioze online.<br>**3.2.5** Shkolla krijon mundësinë për shkëmbimin e mendimeve dhe përmbledh diskutimet e realizuara në Forumin e Shkollës së Magjistraturës dhe në platforma të tjera.<br>**3.2.6** Shkolla mirëmban, përditëson dhe plotëson faqen e saj zyrtare.<br>**3.2.7** Shkolla krijon një komunikim aktiv në rrjetet sociale dhe profesionale (linkedin, twitter, facebook, instagram).<br>**3.2.8** Platforma elektronike SMVSHM kryen të gjitha funksionalitetet për të cilat është krijuar.<br>**3.2.9** Shkolla trajnon stafin administrativ dhe akademik për përdorimin e SMVSHM-së. |
| **Objektivi specifik 3.3:**<br>Shkolla është e orientuar drejt kërkesave të tashme dhe të ardhshme që lidhen me procesin e integrimit në BE. | **Rezultati i kërkuar 1:**<br>Shkolla është në gjendje të ndjekë dhe monitorojë ecurinë e të gjitha detyrimeve që i burojnë si rrjedhojë e procesit të integrimit në BE. | **3.3.1** Shkolla ka hartuar një metodologji monitoruese të ecurisë së zbatimit të detyrimeve të marra përsipër si rrjedhojë e procesit të integrimit në BE.<br>**3.3.2** Shkolla monitoron ecurinë e zbatimit të masave sipas masës 3.3.1 me një frekuencë vjetore. |

| | | |
|---|---|---|
| | **Rezultati i kërkuar 2:**<br>Ligji i BE-së është pjesë integrale e formimit të kandidatëve dhe e trajnimit të magjistratëve. | **3.3.3** E drejta e BE-së është pjesë integrale e planeve dhe programeve mësimore të formimit fillestar dhe Programit të Formimit Vazhdues.<br>**3.3.4** Shkolla forcon ekspertizën e saj me ekspertë të huaj në tema që lidhen me BE-në. |

## 8. MONITORIMI DHE RAPORTIMI I STRATEGJISË

Strategjia dhe Plani i Veprimit (PV) i Shkollës së Magjistraturës (SHM) 2024-2028 përcakton si vijon lidhur me Mekanizmin e Monitorimit të zbatimit të tij:

Plani i Veprimit bazohet në objektivat e përgjithshme dhe specifike të përcaktuara në Strategjinë e SHM-së 2024-2028 me qëllimin e paraqitjes, parashikimit dhe përcaktimit sa më të qartë të mundshëm të përgatitjes, zhvillimit të qëndrueshëm dhe profesional të të gjitha kategorive që i nënshtrohen aktiviteteve të SHM-së.

Në zbatimin e një metodologjie të qartë dhe gjithëpërfshirëse, Plani i Veprimit dhe Indikatorët e Performancës (IP) ofrojnë veprime konkrete me tregues të qartë për përmirësimin dhe menaxhimin efektiv të aktiviteteve të SHM-së në aspektin e politikave akademike, financiare dhe administrative për përmbushjen e qëllimeve strategjike, të SHM.

Të gjitha masat në PV të Strategjisë janë prioritizuar, buxhetuar dhe vendosur në faza. Ndarja e masave që do të ndërmerren sipas fazave kryhet në përputhje me kapacitetet e pritura të thithjes/rekrutimit të SHM-së. Qëllimi i ndarjes në faza ndjek një kurs logjik në mënyrë që zbatimi i tyre të mund të realizohet në mënyrë kronologjike.

SHM do ta monitorojë Strategjinë nëpërmjet strukturave të saj të brendshme. Kjo strukturë e menaxhimit mbledh dhe analizon raporte periodike mbi zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit. Çdo sektor raporton për nivelin e zbatimit të secilës politikë dhe aktiviteti, problemet e hasura dhe vlerësimin e përgjithshëm të progresit të Strategjisë. Rrjedhimisht, ky mekanizëm do të mundësojë përcaktimin e masave korrigjuese, strukturën përgjegjëse për korrigjimin dhe sanksionet e duhura. Për këtë qëllim, treguesit e performancës do të analizohen për çdo aktivitet, për shembull raportet e vlerësimit, rekomandimet, pyetësorët e plotësuar, pasojat që kanë ardhur etj.

Struktura / mekanizmi përgjegjës për monitorimin e Strategjisë do të përcaktohet nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës.

Zbatimi i Strategjisë do të monitorohet nëpërmjet sistemit të vlerësimit të performancës dhe rezultateve të parashikuara në PV dhe IP, që mbështet qëllimet e politikave dhe objektivat e programit dhe siguron që planifikimi i politikave, buxhetimi dhe monitorimi të jenë të lidhura dhe të funksionojnë në mënyrë efikase. Ky sistem do të shërbejë si bazë për përgatitjen e procesit buxhetor vjetor, duke ofruar objektiva të politikave, të cilat përfshihen në udhëzimet e përgatitjes së buxhetit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të gjitha institucionet.

Gjithashtu, përfaqësuesit e donatorëve ndërkombëtarë që ndihmojnë SHM-në ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e komitetit të monitorimit.

Propozohet që mekanizmi të quhet: **Komiteti i Monitorimit të Brendshëm.**

Rregullat e brendshme të funksionimit të Komitetit të Monitorimit do të miratohen nga Drejtori i Shkollës së Magjistraturës.

**POLITIKA STRATEGJIKE NR. 1**
**Garantimi i aksesit në profesionin e magjistratit dhe nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë**

| | | | Periudha e zbatimit | | Kosto indikative (Lekë) | | Burimi i financimit | | Struktura përgjegjëse | Koment e/ Progresi |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr | Objektivat specifikë | Masat | Viti i fillimit | Viti i mbarimit | Plan | Fakt | Buxheti i shtetit | Donatorë | | |
| 1.1 | Shkolla është një mjedis ftues dhe lehtësues për gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i aktivitetit të saj | **1.1.1** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një material shpjegues të procesit të provimit të pranimit: | çdo vit | çdo vit | 19000 | | X | | Kancelari/ Specialisti i IT-së | |
| | | **1.1.2** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një përmbledhje të detajuar të programit të provimit të pranimit të konkretizuar me shembuj dhe pyetje nga tezat e mëparshme; | çdo vit | çdo vit | 500000 | | X | | Këshilli Pedagogjik /Drejtori /Këshilltari Akademik/ Departamenti i PFF-së | |
| | | **1.1.3** Shkolla ka hartuar dhe publikuar një material shpjegues mbi metodologjinë e vlerësimit të provimit të pranimit; | 2024 | 2025 | 500000 | | X | | Këshilli Pedagogjik /Drejtori /Këshilltari Akademik/ Departamenti i PFF-së | |
| | | **1.1.4** Shkolla bashkëpunon me Fakultetin e Drejtësisë së UT dhe të Universiteteve të tjera të paracaktuara, bazuar në numrin e studentëve të tyre, me qëllim përthithjen e studentëve më të mirë në profesionin e magjistratit; | çdo vit | çdo vit | 40000 | | X | | Këshilltari Akademik | |
| | | **1.1.5** Shkolla organizon | çdo vit | çdo vit | 50000 | | X | | Dretjori/Departamenti | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | trajnime para hyrjes në provimin e pranimit; | | | | | | | i PFF-së/ Kancelari | |
| | | **1.1.6** Shkolla organizon fushata ndërgjegjësimi për kandidatët potencialë dhe kujdeset që ato të jenë gjithpërfshirëse dhe të nxisin pjesëmarrjen edhe të kandidatëve të shkolluar jashtë Shqipërie. | çdo vit | çdo vit | 200000 | | X | | Departamenti i PFF-së/ Sektori i PFF-së/ Kancelari | |
| 1.2 | Analiza dhe rishikimi i formatit dhe përmbajtjes së provimit të pranimit në Shkollë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike është në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për kandidatët, në çdo moment të karrierës së tyre, për të pasur sukses në provimin hyrës. | **1.2.1** Shkolla analizon (përpunon të dhënat dhe i vlerëson ato) rezultatet e procesit të konkurimit vit pas viti dhe i bën të njohura ato për aktorë të tjerë kryesorë të sistemit të drejtësisë (KLGJ, KLP, PP, Fakultete të Drejtësisë); | çdo vit | çdo vit | 20000 | | X | | Sektori i IT-së / Sektori i PFF-së | |
| | | **1.2.2** Shkolla rishikon formatin e provimit të pranimit me qëllim maksimizimin e përshtatshmërisë së tij për çdo praktikues/studiues të së drejtës; | 2024 | 2028 | 1000000 | | X | | Drejtori/Pedagogët/ Sektori i Formimit Fillestar | |
| | | **1.2.3** Shkolla rishikon përmbajtjen e provimit të pranimit vit pas viti për të reflektuar ndryshime që ka pësuar ligji/praktika; | çdo vit | çdo vit | 60000 | | X | | Këshilli Drejtues/ Këshilli Pedagogjik / Drejtori / Departamenti i PFF-së / Këshilltari | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **1.2.4** Shkolla ka një grup pune të përhershëm që vlerëson nevojën për ndryshime në procesin e rekrutimit. | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Drejtori/ Departamenti i PFF/ Pedagogët / Këshilltari Akademik/ Sektori i PFF-së | |
| 1.3 | Shkolla ka të gjithë mekanizmat nënligjorë dhe institucionalë për realizimin e një procesi konkurimi të pavarur, të paanshëm, transparent dhe bazuar në meritë. | **1.3.1** Shkolla ka riparë Rregulloren e Brendshme dhe rregulla të tjera që lidhen me procesin e konkurimit; | çdo vit | çdo vit | 60000 | | X | | Keshilli Drejtues/ Keshilli pedagogjik / Drejtori / Departamenti i PFF / Këshilltari Akademik | |
| | | **1.3.2** Shkolla ka ngritur mekanizma vlerësues për ecurinë e procesit të provimit dhe reflekton rezultatet e tij. | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Këshilli Drejtues/ Këshilli Pedagogjik / Drejtori / Drejtues i PFF-së /Kancelari / Këshilltari / Sektori i PFF-së/ Sektori i IT-së | |
| **POLITIKA STRATEGJIKE NR. 2**<br><br>**Kontributi në cilësinë e drejtësisë në vend** | | | | | | | | | | |
| 2.1 | Kurrikula e Programit të Formimit Fillestar mundëson aftësimin e kandidatëve për profesionin e magjistratit/në punësit civil gjyqësor dhe avokatëve të shtetit | **2.1.1** Shkolla ka një grup pune të përcaktuar që analizon nevojat për ndryshim/plotësim të planeve dhe programeve mësimore për ti përshtatur me profesionin e magjistratit, nëpunësit civil gjyqësor, | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Drejtori/ Departamenti i PFF-së/ Pedagogët / Këshilltari Akademik/ Sektori i PFF-së | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | avokatit të shtetit dhe kancelarit; | | | | | | | | |
| | **2.1.2** Shkolla përmirëson planet dhe programet mësimore të PFF bazuar në rezultatet e kësaj analize. | çdo vit | çdo vit | 65000 | | X | | Këshilli Drejtues/ Këshilli Pedagogjik / Drejtori / Departamenti i PFF-së / Këshilltari Akademik / Sektori i PFF-së | |
| | **2.1.3** Shkolla bashkëpunon me KLGJ/KLP/PP, këshillat e gjykatave dhe prokuroritë për vlerësimin e nevojave për trajnim, në baza periodike. | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Drejtori/ Pergjegjesi i PFF-së/ Pedagog / Këshilltari Akademik/ Përgjegjësi i sektorit të PFF-së | |
| Programi i Formimit Vazhdues mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës. | **2.2.1** Shkolla rishikon metodologjinë e analizës së nevojave për trajnim bazuar në standardet ndërkombëtare duke reflektuar analizën e nevojave për trajnim të magjistratëve të rinj, nevojën për specializim të magjistratëve sipas fushave të caktuara dhe karrierës që kanë në gjyqësor apo prokurori dhe nevojën për trajnim të kategorive të | çdo vit | çdo vit | 55000 | | X | | Këshilli Pedagogjik /Drejtori /Këshilltari Akademik/ Departamenti i PFV-së/ Sektori i PFV-së | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | tjera si ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit, ispektorët e ILD, kancelarët e gjykatave/prokurorive etj; | | | | | | | | |
| | **2.2.2** Shkolla bën vlerësim ex post për ecurinë e cikleve të specializuara të trajnimeve me synim analizën e nevojës për vijimësinë e tyre; | 2026 | 2028 | 55000 | | X | | Drejtori /Këshilltari Akademik/ Departamenti I PFV/ Sektori i PFV | |
| | **2.2.3** Shkolla bashkëpunon ngushtësisht dhe mbi baza periodike me KLGj/KLP, Këshillat e gjykatave, magjistratët në sistem, subjektet e tjera përfituese të trajnimit dhe organe të tjera të përfshirë në procesin e analizës së nevojave për trajnim, bazuar në ligj, Rregullore dhe marrëveshje dypalëshe (nëse është rasti); | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Drejtori/ Departamenti i PFV-së/ Pedagog / Këshilltari Akademik/ Sektori i PFV-së | |
| | **2.2.4** Programi i Formimit Vazhdues ofron cikle trajnimi për magjistratët e rinj në sistem. | çdo vit | çdo vit | 10 trajnime 1 ditore*68815 leke (2 | | X | | Departamenti i FV-së/ Sektori i PFV-së | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | module 5 ditore) | | | | | |
| | | **2.2.5** Programi i Formimit Vazhdues ofron cikle trajnimi disa ditore të cilat synojnë trajtim ndërdisiplinor dhe/ose shterues të cështjeve të ndryshme të së drejtës. | çdo vit | çdo vit | 55 trajnime 1 ditore*68815 leke (11 module 5 ditore) | | X | | Departamenti i FV/ Sektori i PFV-së | Numri i trajnimeve do të jetë në trend rritës nga viti në vit |
| 2.2 | | **2.2.6** Programi i Formimit Vazhdues ofron aktivitete trajnuese me rëndësi kombëtare/ndërkombëtare, përfshirë trajnime mbi ligjin e BE, integritetin e magjistratit, etikën, shtetin e së drejtës, etj; | çdo vit | çdo vit | 54 Trajnime 1 ditore** 68815 leke | | X | | Departamenti i FV-së/ Sektori i PFV-së | Numri i trajnimeve do të jetë në trend rritës nga viti në vit |
| | | **2.2.7** Programi i Formimit Vazhdues parashikon trajnime të vecanta, “tailor made”, për magjistratët e të tre niveleve, për funksione të vecanta që ata mund të marrin, si drejtues, magjistratë shtypi, mentorë, etj. | çdo vit | çdo vit | 15 trajnime 1 ditore*68815 leke ( 3 module 5 ditore) | | X | | Departamenti i FV-së/ Sektori i PFV-së | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **2.2.8** Programi i Formimit Vazhdues parashikon trajnime të posaçme dhe/ose integron në aktivitete trajnuese këshilltarët/ndihmësit ligjorë, avokatët e shtetit, inspektorët e ILD, kancelarët e gjykatave/prokurorive dhe administratën gjyqësore (kur vlerësohet e përshtatshme). | çdo vit | çdo vit | 15 trajnime 1 ditore*68815 lekë (3 module 5 ditore) | | X | | Departamenti i FV/ Sektori i PFV-së | |
| | **2.2.9** Shkolla organizon trajnime rajonale në bashkëpunim të ngushtë me gjykatat/prokuroritë "pritëse". | çdo vit | çdo vit | 10 trajnime 1 ditore*68815 leke | | X | | Departamenti i FV-së/ Sektori i PFV-së | |
| | **2.2.10** Shkolla ndjek një metodologji interaktive, bazuar në kompetencat dhe aftësitë e subjektit të trajnimit dhe të përputhur me standardet ndërkombëtare, në realizimin e aktiviteteve trajnuese. | 2025 | 2028 | 55000 | | X | | Drejtori/ Pergjegjesi i PFV/ Këshilltari Akademik/ Pergjegjesi i Sektorit PFV | |
| | **2.2.11** Shkolla realizon vlerësim afatshkurtër dhe afatgjatë të impaktit të trajnimit | 2026 | 2028 | 55000 | | X | | Drejtori/ Përgjegjësi i PFV-së / Këshilltari/ Përgjegjësi | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | bazuar në një metodologji të standardizuar (standardet e EJTN) për procesin e vlerësimit të impaktit të trajnimit në punën e magjistratëve; | | | | | | | i Sektorit të PFV-së | |
| | | **2.2.12** Shkolla publikon raportet e hartuara në përfundim të këtij procesi. | 2027 | 2028 | 3100 | | X | | Specialisti i IT-së | |
| 2.3 | Shkolla ka mekanizma transparentë dhe efikas për përthithjen e ekspertizës së lartë profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre. | **2.3.1** Shkolla ndërmerr, në mënyrë periodike, një proces promovues/informues të mundësive për angazhim në PFF dhe PFV; | çdo vit | çdo vit | 25000 | | X | | Këshilli Drejtues/Këshilli Pedagogjik / Kancelari/ Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **2.3.2** Shkolla rishikon rregullat për konkurim në PFF dhe PFV; | 2024 | 2025 | 25000 | | X | | Këshilli Drejtues/Këshilli Pedagogjik / Kancelari dhe Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **2.3.3** Shkolla realizon procesin e konkurimit dhe bën publike vendimmarrjen e saj; | çdo vit | çdo vit | 25000 | | X | | Këshilli Drejtues/Këshilli Pedagogjik / Kancelari dhe Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **2.3.4** Shkolla vlerëson nevojat për trajnim trajnerësh në mënyrë të përvitshme. | çdo vit | çdo vit | 45000 | | X | | Drejtori/ Përgjegjësi i PFF-së / Përgjegjësi i PFV-së/Këshilltari Akademik | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **2.3.5** Shkolla realizon aktivitete trajnimi për trajnerët dhe/ose bashkëpunon ngushtësisht me partnerët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në realizimin e tyre; | çdo vit | çdo vit | 2 trajnime 1 ditore*6 8815 leke | | X | | Departamenti i FV-së/ Sektori i PFV-së | |
| | | **2.3.6** Shkolla ndërmjetëson në ofrimin e mundësive për trajnim të trajnerëve të saj në Shkollat homologe ose institucione ndërkombëtare të trajnimit. | çdo vit | çdo vit | 27000 | | X | | Drejtori/ Sektori i IPMJ-së | |
| 2.4 | Mekanizmat e vlerësimit dhe llogaridhënies të performancës së Shkollës së Magjistraturës janë transparentë dhe garantues të pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e saj, njëherazi garantues të cilësisë së drejtësisë. | **2.4.1** Shkolla ka riparë rregullat e parashikuara në Rregulloren e Brendshme lidhur me vlerësimin e performancës së stafit të angazhuar në mësimdhënie dhe ekspertizë; | 2024 | 2025 | 80000 | | X | | Këshilli Drejtues/Këshilli Pedagogjik /Drejtori/ Përgj. i PFF-së/ Përgj. i PFV-së/ Kancelari/ Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **2.4.2** Shkolla harton raporte individuale periodike për stafin e angazhuar në mësimdhënie dhe ekspertizë dhe i njofton rezultatet e tij subjektit të vlerësimit. | çdo vit | çdo vit | 60000 | | X | | Përgj. i PFF-së/Përgj. i PFV-së/ Përgj. Sektorit të PFF-së/ Këshilltari Akademik/ Sektori i PFV-së | |
| | | **2.4.3** Shkolla ka hartuar një metodologji | 2025 | 2026 | 45000 | | X | | Drejtori/Kancelari/ | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | për mënyrën e vlerësimit të performancës së Departamenteve; | | | | | | | Keshilltari/ Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **2.4.4** Shkolla ka një staf administrativ të kualifikuar dhe të trajnuar për të realizuar procese kërkimi, përpunimi të dhënash, analize, etj. | çdo vit | çdo vit | 600000 | | X | | Drejtori/Kancelari/ Përgj. i Sek. të SHBNJ-së | |
| | | **2.4.5** Shkolla publikon raportet e monitorimit të ecurisë së kësaj strategjie në mënyrë vjetore. | çdo vit | çdo vit | 90000 | | X | | Komiteti i Monitorimit (Drejtori/ Përgj. e Departamenteve/Kancelari/Këshilltari/ Përgjegjësit e Sektorit) | |
| **POLITIKA STRATEGJIKE NR. 3**<br>**Kërkimi shkencor dhe publikimet. Inovacioni dhe BE** | | | | | | | | | | |
| 3.1 | Shkolla është e angazhuar në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës dhe nxjerr produkte shkencore dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë. | **3.1.1** Shkolla ka një mekanizëm dhe metodologji përzgjedhëse të personave që do të jenë pjesë e grupeve të kërkimit dhe studimit | 2025 | 2026 | 60000 | | X | | Këshilli Drejtues/ Bordi i Redaktorëve /Drejtori /Këshilltari i Botimeve/ Departamenti i Publikimeve | |
| | | **3.1.2** Shkolla trajnon | 2025 | 2026 | 2 Trajnim | | X | | Departamenti i | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | kërkuesit e rinj që i bashkohen grupeve të studimit/kërkimit. | | | e 1 ditore * 68815 leke | | | | Publikimeve/Sektori i Botimeve dhe Publikimeve | |
| | | **3.1.3** Shkolla realizon punë paraprake kërkimore dhe analizuese në funksion të studimit të grupeve të ngritura, vlerëson produktet e realizuara dhe vendos për mundësitë dhe mjetet për vizibilitetin e tyre. | 2025 | 2026 | 75000 | | X | | Bordi i Redaktorëve/Drejtori/Këshilltari i Botimeve/ Departamenti i Publikimeve/ Sektori i Studimeve dhe Botimeve | |
| | | **3.1.4** Shkolla publikon, në mënyrë periodike, përmbledhje të transkriptimeve të përmbajtjes së trajnimeve të zhvilluara në Programin e Formimit Vazhdues; | çdo vit | çdo vit | 65000 | | X | | Departamenti i Publikimeve /Këshilltari i Botimeve/ Sektori i Botimeve/ Sektori i IT-së | |
| | | 3.1.5 Shkolla boton Revistën shkencore "Jeta juridike" dhe "Magjistrati"; | çdo vit | çdo vit | 1260000 | | X | | Departamenti i Publikimeve/Sektori i Botimeve dhe Publikimeve | |
| | | **3.1.6** Shkolla përgatit manuale, module/cikle leksionesh për lëndë apo tema që trajtohen në procesin e Formimit | çdo vit | çdo vit | 420000 | | X | | Departamenti i Publikimeve/Sektori i Botimeve dhe Publikimeve | |

| | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Fillestar të magjistratëve, nga grupe autorësh. | | | | | | | | |
| | | **3.1.7** Shkolla boton tituj me praktikë gjyqësore (*Case study*) dhe publikime të tjera shkencore në funksion të studiuesve të së drejtës. | çdo vit | çdo vit | 420000 | | X | | Departamenti i Publikimeve/Sektori i Botimeve dhe Publikimeve | |
| | | **3.1.8** Shkolla organizon një Konferencë shkencore në vit mbi zhvillime të rëndësishme të së drejtës. | çdo vit | çdo vit | 700000 | | X | X | Drejtori/Kancelari/ Këshilltarët/ Përgjegjësit e Sektorëve | |
| 3.2 | Metodat teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht | **3.2.1** Shkolla përdor module e-learning të prodhuara në Evropë ose të krijuara në Shkollë | çdo vit | çdo vit | 71000 | | X | | Sektori i PFF-së/Sektori i PFV-së/Sektori i IT-së | |
| | | **3.2.2** Shkolla shkëmben burime (dokumente, botime shkencore, kurrikula trajnimi dhe çdo "mjet trajnimi" tjetër i cili do të mund të kontribuojë në përmirësimin e njohurive dhe dijeve të sistemeve gjyqësore dhe juridike përkatëse) me | çdo vit | çdo vit | 75000 | | X | | Departamenti i Botimeve/ Këshilltari i Botimeve/ Këshilltari Akademik/ Sektori i IPMJ-së | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | shkollat homologe dhe partnerët kombëtarë/ndërkombëtarë | | | | | | | |
| | | **3.2.3** Shkolla ka kapacitete saj për të zhvilluar, dorëzuar dhe menaxhuar projekte që lidhen me trajnimin gjyqësor, veçanërisht në kuadër të Programit të BE-së për Drejtësi dhe në partneritet me EJTN dhe anëtarët e saj | çdo vit | çdo vit | 85000 | | X | | Drejtori/ Kancelari/ Departamenti i PFV-së/ Këshilltari i Botimeve/ Këshilltari Akademik/ Sektori Botimeve/ Sektori IPMJ-së |
| | | **3.2.4** Shkolla ka bibliotekë digjitale të pasuruar në mënyrë të vazhdueshmedhe abonime në biblioteka prestigjoze online. | çdo vit | çdo vit | 300000 | | X | | Departamenti i Botimeve dhe Publikimeve/ Kancelari/Sektori i Botimeve dhe Publikimeve | |
| | | **3.2.5** Shkolla krijon mundësinë për shkëmbimin e mendimeve dhe përmbledh diskutimet e realizuara në Forumin e Shkollës së Magjistraturës dhe në | çdo vit | çdo vit | 185000 | | X | | Pedagogët e Brendshëm / Këshilltari i Botimeve/ Sektori i Botimeve | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | platforma të tjera. | | | | | | | |
| | | **3.2.6** Shkolla mirëmban, përditëson dhe plotëson faqen e saj zyrtare. | çdo vit | çdo vit | 26000 | | X | | Sektori i IT-së | |
| | | **3.2.7** Shkolla krijon një komunikim aktiv në rrjetet sociale dhe profesionale (linkedin, twitter, facebook, instagram). | çdo vit | çdo vit | 31000 | | X | | Sektori i IT-së/Sekretari shkencor për komunikimin | |
| | | **3.2.8** Platforma elektronike SMVSHM kryen të gjitha funksionalitetet për të cilat është krijuar. | 2024 | 2028 | 2.8E+07 | | X | | Kancelari/ Sektori IT/ Sektori i SHBNJ-së | |
| | | **3.2.9** Shkolla trajnon stafin administrativ dhe akademik për përdorimin e SMVSHM. | çdo vit | çdo vit | 300000 | | X | | Kancelari/ Sektori i IT-së | |
| 3.3 | Shkolla është e orientuar drejt kërkesave të tashme dhe të ardhshme që lidhen me procesin e integrimit në BE. | **3.3.1** Shkolla ka hartuar një metodologji monitoruese të ecurisë së zbatimit të detyrimeve të marra përsipër si rrjedhojë e procesit të integrimit në BE. | 2024 | 2025 | 62000 | | X | | Drejtori/ Departamenti i PFF-së dhe PFV-së/Sektori i IPMJ-së | |
| | | **3.3.2** Shkolla monitoron ecurinë e zbatimit të masave sipas masës 3.3.1 me një | çdo vit | çdo vit | 62000 | | X | | Drejtori/ Departamenti i PFF-së dhe PFV- | |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | frekuencë vjetore. | | | | | | | së/Sektori IPMJ-së | |
| | **3.3.3** E drejta e BE është pjesë integrale e planeve dhe programeve mësimore të trajnimit fillestar dhe programit të Formimit Vazhdues. | çdo vit | çdo vit | 1600000 | | X | X | | |
| | **3.3.4** Shkolla forcon ekspertizën e saj me ekspertë të huaj në tema që lidhen me BE-në. | çdo vit | çdo vit | 1000000 | | | X | Drejtori/ Departamenti i PFF-së dhe PFV-së/Kancelari/Sektori i IPMJ-së | |

**SHTOJCA nr. 2**

## INDIKATORËT MATËS TË PERFORMANCËS

Matja e progresit të Strategjisë është parashikuar të realizohet me anë të masave dhe indikatorëve. Përcaktimi dhe monitorimi/vlerësimi i indikatorëve të duhur shërben për të dhënë tregues faktikë dhe të matshëm të performancës së Shkollës, për të arritur në konkluzione të sakta nëse zbatimi i masave, rregullave e standardeve po ndodh ose jo në nivelet e dëshiruara, cilat objektiva kanë shfaqur problematika, çfarë adresimi mund t'iu bëhet këtyre problemeve që mund t'i shërbejë të ardhmes. Në këtë mënyrë, vlerësimi i performancës ndihmon në identifikimin e hapave dhe masave për të përmirësuar vazhdimisht veprimtarinë e SHM-së përballë objektivave të vendosura.

Indikatorët matës dhe shpjegimi i metodologjisë së matjes së tyre është si vijon:

1. Përqindja e vizitorëve të faqes zyrtare të Shkollës, gjatë muajve të zhvillimit të procesit të pranimit.
2. Përqindja e konkurrentëve që kanë marrë pjesë në provimin e pranimit.
3. Përqindja e pjesëmarrësve në provim që arrijnë të marrin më shumë se 60% të testit të fazës së parë.
4. Përqindja e konkurrentëve që arrijnë të marrin më shumë se 60% në fazën e dytë të provimit të pranimit.
5. Përqindja e kandidatëve që arrijnë rezultate të larta përgjatë PFF-së.
6. Përqindja e magjistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë përzgjedhur nga ana e Shkollës.
7. Përqindja e magjistratëve që kanë aplikuar për të kontribuar me ekspertizë në PFF dhe PFV.
8. Përqindja e stafit administrativ të trajnuar.
9. Numri i publikimeve të SHM-së në një vit.
10. Numri i përdoruesve aktivë të platformës elektronike SMVSHM.
11. Numri i raporteve statistikore të prodhuara nga SMVSHM.

| MATRICA E INDIKATORËVE TË PERFORMANCËS | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Kodi** | **Lidhja me objektivin specifik** | **Emërtimi i indikatorit** | **Përshkrimi i indikatorit** | **Metodologjia e llogaritjes dhe matja e indikatorit** | **Vlera e synuar** | **Frekuenca e raportimit** | **Sektori/nëpunësi përgjegjës** |
| **1.1.1** | Objektivi specifik 1.1 Shkolla është një mjedis ftues dhe lehtësues për të gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i aktivitetit të saj. | Përqindja e vizitorëve të faqes zyrtare e Shkollës gjatë muajve të zhvillimit të procesit të pranimit (janar- mars). | Ky indikator synon të masë performancën e Shkollës në çështje të aksesit në informacion nëpërmjet numrit të vizitorëve të faqes zyrtare përgjatë periudhës së provimit të pranimit. | Përqindja e numrit të vizitorëve në periudhën janar- mars do të krahasohet me përqindjen e mesatares së vizitorëve në faqen e Shkollës përgjatë një viti kalendarik. Numri i vizitorëve të faqes në periudhën janar-mars/mesataren e numrit të vizitorëve të faqes përgjatë vitit x 100 | Rritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Fillestar<br>Sektori IT |
| **1.1.2** | Objektivi specifik 1.1 Shkolla është një mjedis ftues dhe lehtësues për të gjithë personat që aspirojnë të jenë pjesë e sistemit gjyqësor në pozicionin e magjistratit ose nëpunësve të tjerë civilë gjyqësorë, subjekt i aktivitetit të saj. | Përqindja e konkurrentëve që kanë marrë pjesë në provim. | Ky indikator është sa numerik, pasi synon të masë nivelin interesit në provimin e pranimit nga konkurrentët, ashtu edhe cilësor, pasi na jep të dhëna lidhur me konkurrencën në provimin e pranimit ndër vite. | Përqindja e kërkuar do të vendos përballë numrin e konkurrentëve në një vit dhe numrin e kuotave për atë vit. Llogaritja me kuota bëhet për të shmangur marzhin e gabimit nëse indikatori do të shprehte thjesht raportin e konkurrentëve nga viti në vit, pa marrë në konsideratë se | Rritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Fillestar<br>Sektori IT |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | interesi i tyre lidhet edhe me numrin e vakancave, ose mudnësitë reale të tyre për të fituar. | | | |
| **1.2.1** | Objektivi specifik 1.2 Analiza dhe rishikimi i formatit dhe përmbajtjes së provimit të pranimit në Shkollë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike është në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për kandidatët, në çdo moment të karrierës së tyre, për të pasur sukses në provimin hyrës. | Përqindja e pjesëmarrësve në provim që arrijnë të marrin më shumë se 60% të testit të fazës së parë. | Ky indikator synon të masë përshtatshmërinë e provimit të pranimit në fazën e parë. Një rezultat i ulët i konkurrentëve që e kalojnë këtë fazë shikohet si një tregues negativ i këtij synimi. | Llogaritja e këtij indikatori bëhet fillimisht përmes raportit ndërmjet numrit të konkurrentëve që kanë marrë më shumë se 60% të provimit, me numrin e përgjithshëm të konkurrentëve në atë provim, dhe llogaritja e dytë bëhet duke krahasuar këtë raport nga viti në vit. | Rritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Fillestar<br>Sektori IT |
| **1.2.2** | Objektivi specifik 1.2 Analiza dhe rishikimi i formatit dhe përmbajtjes së provimit të pranimit në Shkollë në mënyrë të vazhdueshme dhe periodike është në funksion të ofrimit të mundësive të barabarta për kandidatët, në çdo moment të karrierës së tyre, për të pasur sukses në provimin hyrës. | Përqindja e konkurrentëve që arrijnë të marrin më shumë se 60% në fazën e dytë të provimit të pranimit. | Ky indikator synon të masë përshtatshmërinë e provimit të pranimit në fazën e dytë. Një rezultat i ulët i konkurrentëve që e kalojnë këtë fazë shikohet si një tregues negativ i këtij synimi. | Llogaritja e këtij indikatori bëhet fillimisht përmes raportit ndërmjet numrit të konkurrentëve që kanë marrë më shumë se 60% të provimit, me numrin e përgjithshëm të konkurrentëve në atë provim, dhe llogaritja e dytë bëhet duke krahasuar këtë raport nga viti në vit. | Rritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Fillestar<br>Sektori IT |
| **2.1.1** | Objektivi specifik 2.1 Kurikula e Programit të Formimit Fillestar mundëson aftësimin e kandidatëve për profesionin e magjistratit/nëpunësit | Përqindja e kandidatëve që arrijnë rezultate të larta përgjatë PFF-së | Ky indikator synon të masë përshtatshmërinë e Programit të Formimit Fillestar për aftësimin e kandidatëve për | Llogaritja e këtij indikatori bëhet fillimisht përmes raportit ndërmjet numrit të kandidatëve që janë vlerësuar | Rritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Fillestar<br>Sektori i Teknologjisë së Informacionit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | civil gjyqësor dhe avokatëve të shtetit | | magjistratë, avokatëve të shtetit dhe nëpunësit e tjerë civil gjyqësor. Gjithashtu, ky indikator na jep edhe një premisë lidhur me cilësinë e kandidatëve nga viti në vit. | shumë mirë dhe shkëlqyeshëm, me numrin e përgjithshëm të kandidatëve, dhe llogaritja e dytë bëhet duke krahasuar këtë raport nga viti në vit. | | | |
| **2.2.1** | Objektivi specifik 2.2 Programi i Formimit Vazhdues mbështet nevojat për trajnim të sistemit gjyqësor në të gjitha nivelet dhe vlerëson çështje të rëndësishme kombëtare dhe ndërkombëtare në zhvillimin e së drejtës. | Përqindja e magjistratëve që ndjekin rregullisht trajnimet për të cilat janë përzgjedhur nga ana e Shkollës. | Matja e këtij indikatori synon të reflektojë përshtatshmërinë e Programit të Formimit Vazhdues për subjektet e tij. Gjithashtu, ky indikator do të shërbejë edhe për të parë marrëdhënien që krijohet mes Shkollës dhe subjekteve të saj, se sa ata janë korrektë dhe të angazhuar në formimin e tyre profesional. | Llogaritja e këtij indikatori do të bëhet bazuar në raportin mes numrit të subjekteve të trajnimit që janë ftuar në një aktivitet trajnues, me numrin e atyre që kanë marrë pjesë efektivisht në trajnim. Kjo llogaritje e prezumon se ftesat janë drejtuar vetëm ndaj atyre që kanë shprehur interes për këto trajnime dhe kanë aplikuar. Krahasimi i përqindjeve nga viti në vit do ti shërbej vlerësimit të ecurisë së këtij treguesi. | Ritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Vazhdues<br>Sektori i Teknologjisë së Informacionit |
| **2.3.1** | Objektivi specifik 2.3 Shkolla ka mekanizma transparentë dhe efikas për përthithjen e ekspertizës së lartë profesionale dhe trajnimin e vazhdueshëm të tyre. | Përqindja e magjistratëve që kanë aplikuar për të kontribuar me ekspertizë në PFF dhe PFV. | Ky indikator synon të masë interesin e magjistratëve për të qenë aktiv në mësimdhënie dhe ekspertizë në Shkollë. Duke qenë se synimi I i Shkollës është që formimi dhe trajnimi në | Llogaritja e këtij indikatori do të bëhet nëpërmjet raportit të numrit të numrit të aplikimeve në Shkollë për të qenë pjesë e stafit akademik dhe | Ritëse | Vjetore | Sektori i Formimit Vazhdues<br>Sektori i Burimeve Njerëzore<br>Sektori i Teknologjisë së Informacionit |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Shkollë të realizohet, në pjesën më të madhe të tij, nga vetë magjistratët, ky indikator ka shumë vlerë në përcaktimin e politikave të Shkollës dhe programimin e aktiviteteve nga ana e saj. | ekspertizës, me numrin e përgjithshëm të magjistratëve në vend. Përqindjet do të krahasohen nga viti në vit. *Ky indikator do të kërkojë krahasim me një tregues tjetër në rast se kompozimi I PFF dhe PFV do të ketë ndryshime të tilla të rëndësishme që do të ulin/rrisin ndjeshëm vakancat për ekspertizë. | | | |
| **2.4.1** | Objektiv specifik 2.4 Mekanizmat e vlerësimit dhe llogaridhënies të performancës së Shkollës së Magjistraturës janë transparentë dhe garantues të pavarësisë dhe paanësisë në vendimmarrjet e saj, njëherazi garantues të cilësisë së drejtësisë. | Përqindja e stafit administrativ të trajnuar. | Ky indikator synon të masë rëndësinë që Shkolla i kushton krijimit të mundësive dhe trajnimit të stafit të saj administrativ. | Llogaritja e këtij treguesi do të bëhet duke marrë në konsideratë se do të quhet i trajnuar nëpunësi që ka marrë pjesë në të paktën 1 ditë trajnimi në vit. Përqindja llogaritet nga raporti i numrit të nëpunësve të trajnuar në vit, me numrin e nëpunësve të Shkollës në atë vit x 100 | Ritëse | Vjetore | Kancelar Sektori i Burimeve Njerëzore |
| **3.1.1** | Objektivi specifik 3.1 Shkolla është e angazhuar në veprimtari studimi dhe kërkimi në fusha prioritare të së drejtës dhe nxjerr produkte shkencore dhe informuese në funksion të aktorëve të sistemit të drejtësisë. | Numri i publikimeve të SHM-së në një vit. | Ky indikator synon të masë performancën e Shkollës në drejtim të kontributit në studim dhe publikim. | Llogaritja e këtij treguesi bëhet nëpërmjet krahasimit të numrit të publikimeve nga viti në vit. | Ritëse | Vjetore | Departamenti i Studimeve dhe Publikimeve |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **3.2.1** | Objektivi specifik 3.2 Metodat teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht. | Numri i përdoruesve aktiv të platformës elektronike SMVSHM | Indikatori synon të masë eficencën e SMVSHM-së përmes krahasimit të përdoruesve potencialë të platformës me përdoruesit real. | Llogaritja e këtij treguesi bëhet nëpërmjet krahasimit të numrit të përdoruesve aktivë të SMVSHM nga viti në vit. | Ritëse | Vjetore | Sektori i Teknologjisë së Informacionit |
| **3.2.2** | Objektivi specifik 3.2 Metodat teknologjike dhe inovatore të komunikimit dhe ofrimit të shërbimeve lehtësojnë dhe nxisin bashkëpunimin mes Shkollës dhe subjekteve të saj, por edhe aktorëve të tjerë të rëndësishëm të sistemit të drejtësisë në vend dhe ndërkombëtarisht. | Numri i raporteve statistikore të prodhuara nga SMVSHM. | Indikatori synon të masë përdorimin dhe efikasitetin e SMVSHM për analizën dhe monitorimin e të dhënave në kontekstin e administrimit të shkollës si dhe tregon për intensitetin e përdorimit të kësaj platforme për të monitoruar dhe raportuar për performancën dhe progresin e Shkollës në shumë aspekte. | Llogaritja e këtij treguesi bëhet nëpërmjet krahasimit të numrit të raporteve statistikore të gjeneruara nga SMVSHM nga viti në vit. | Ritëse | Vjetore | Sektori i Teknologjisë së Informacionit |